REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ASCAP
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

RAPORTI JANAR - DHJETOR 2020

DHJETOR, 2020

PËRMBAJTJA

I. AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ASCAP) 4

1.1. Misioni ASCAP 4

1.2. Objektivat e përgjithshëm ASCAP 5

1.3. Sfidat e ASCAP-it 6

II. DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT 6

2.1. Gjendja aktuale 6

2.1.1 Kurrikula 6

2.1.2 Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë 7

2.2. Vizioni i DKK 7

2.3. Misioni i DKK 7

2.4. Vlerat drejtuese të DKK 7

2.5. Detyrat kryesore të DKK 7

2.6. Objektivat e përgjithshëm të DKK 9

2.7. Objektivat e detajuar të DKK 9

2.8. Realizimi i veprimtarive për DKK (Janar – Dhjetor 2020) 11

2.9. Realizimi i veprimtarive shtesë të DKK - së si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID 19 20

III. DREJTORIA E PERFORMANCËS 26

Hyrje 26

3.1. Vizioni 27
3.2. Qëllimi 27
3.3. Vlerësimi i sistemit 27
Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare të nxënësve 28
Vlerësimet nga programet/politikat specifike 29
3.5. Objektivat e përgjithshëm të Drejtorisë së Performancës 31
3.8. Realizimi i veprimtarive për DP për periudhën 01 Janar - 31 Dhjetor 2020 33
IV. DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË 40
4.1 Gjendja aktuale 40
3.3.1 Vlerësimi i cilësisë së kurrikulës 41
3.3.2 Organizimi dhe drejtimi i institucioneve arsimore 41
4.2 Vizioni 41
4.3 Misioni 42
4.4 Vlerat drejtuese 42
4.5 Detyrat kryesore të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë 42
4.6 Objektivat e përgjithshëm për periudhën janar-dhjetor 2020 43
4.7 Objektivat e detajuar për periudhën qershor-dhjetor 2020 43
4.8 Tabela e veprimtarive të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë 44

I. AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ASCAP)

1.1.Misioni ASCAP

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 27.02.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). Misioni i ASCAP është të garantojë performancën e sistemit të arsimit parauniversitar dhe cilësinë e arsimimit parauniversitar publik e privat në përputhje me qasjen e kurrikulës së bazuar në zhvillimin e kompetencave.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) vlerëson performancën e sistemit arsimor parauniversitar, efektshmërinë dhe efiçencën emasave si dhe përmbushjen e objektivave;
b) vlerëson mënyrën e organizimit e të funksionimit të sistemit arsimor parauniversitar dhemerr masat e nevojshme në rast mbivendosjeje funksionesh apo mungese ekzekutimi të detyrave funksionale nga institucionet përgjegjëse;
c) vlerëson si ndërlidhen, koordinohen apo ndërveprojnë institucionet e sistemit arsimorparauniversitar me njëri-tjetrin, duke garantuar nivelin e duhur të integrimit për sigurimin e arsimit parauniversitar cilësor;
d) kryen analiza të ndryshme mbi bazën qendrore e të integruar të të dhënave të sistemit tëarsimit parauniveritar dhe shpërndan informacionin;
e) harton dhe i propozon ministrit për miratim standarde, protokolle, rregulla për ofrimin eshërbimeve arsimore si dhe vlerëson impaktin e tyre në këto shërbime;
f) analizon, zhvillon e rishikon dokumentet si: korniza kurrikulare, programet lëndore dhestandardet, sipas fushave kurrikulare;
g) harton dhe boton dokumentet kurrikulare për arsimin parauniversitar si dhe materiale mbështetëse për zbatimin e kurrikulës, në nivelkombëtar;
h) harton, analizon dhe rishikon standardet e zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare;
i) vlerëson nevojat për zhvillim profesional, programet kombëtare dhe materialet mbështetëse për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
j) organizon zhvillimin profesional dhe menaxhon procesin e kualifikimit të punonjësvearsimorë në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit parauniversitar, publik dhe privat;

k) realizon punë kërkimore-studimore, analiza periodike dhe u ofron ekspertizë strukturave politike e vendimmarrëse për politikat arsimore dhe reformat në fushën e arsimit parauniversitar;

l) ofron këshillim për institucionet arsimore parauniversitare të të gjitha niveleve në fushat e përmbajtjes kurrikulare, të didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne nëmësimdhënie, si dhe në drejtimin e menaxhimit të shkollës dhe arsimit në tërësi;

m) vlerëson, mbi bazë risku, veprimtarinë e institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar dhe të institucionevearsimore publike e private të sistemit të arsimit parauniversitar, për respektimin në vazhdimësi të kushteve dhe detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor, shoqëruar me lënien e detyrave/sugjerimeve/rekomandimeve për përmirësimin e elementeve të caktuara të institucioneveapo gjithë sistemit të arsimit parauniversitar, si: kurrikul, standarde dhe metodologji;

n) nënshkruan marrëveshje dhe bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë, institucione të tjera apo me organizata kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për veprimtari apo aktivitete që lidhen me misionin e saj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

1.2.Objektivat e përgjithshëm ASCAP

Gjatë vitit 2020, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ka pasur këto objektiva të përgjithshme:

1. Kurrikul me standarde europiane dhe më gjerë për zhvillimin e komptencave të të nxënit gjatë gjithë jetës.
2. Zhvillimi profesional i drejtuesve dhe mësuesve për të përmirësuar cilësinë e procesit të mësidhënie-nxënies (formimi fillestar dhe i vazhduar).
3. Nxitja e arsimit cilësor dhe përmirësimi i gjithpërfshirjes në edukim.
4. Krijimi i kornizës së treguesve dhe mbledhja e të dhënave në funksion të vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar, publik dhe privat.
5. Garantimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar publik dhe privat.
6. Hartim i Kornizës për Vlerësimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare.
7. Hartimi i treguesve për vlerësimin e cilësisë së organizimit dhe drejtimit të Institucioneve Arsimore Parauniversitare.

1.3.Sfidat e ASCAP-it

Për të realizuar objektivat, ASCAP përballet me këto sfida:

- Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë për arsimim duhet të bazohet në kompetencat e të nxënit gjatë gjithë jetës.
- Bashkëpunimi me fakultetet e mësuesisë dhe partnerë të tjerë lokalë dhe ndërkombëtarë për rishikimin e kurrikulës së formimit fillestar të mësuesve në përputhje me kurrikulën e zbatuar në arsimin parasuniversitar.
- Komunikimi i vazhdueshëm me institucione në varësi të MASR për mbeldhjen e raporteve dhe materialeve që lidhen me vlerësimin e performancës së sistemit të arsimit parauniversitar.
- Zhvillimi profesional i stafeve të DRAP/ZVAP për inspektimin dhe monitorimin e institucioneve arsimore me qëllim përmirësimin e sistemit të APU.

II. DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT

2.1.Gjendja aktuale

2.1.1 Kurrikula

Kurrikula e reformuar u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve, pavarësisht nga prejardhja ose veçoritë e tyre. Ajo u krijon mundësi të barabarta për sukses secilit nxënës. Kurrikula e re ofron zgjidhje që mbajnë parasysh nevojat vetjake dhe stilet e të nxënit, si dhe përvojat mësimore paraprake të nxënësve, si kusht për përmirësimin e nivelit të arritjeve të tyre. Ajo hartohet dhe zbatohet në harmoni me veçoritë kryesore të grupmoshave dhe në varësi të mundësive dhe të gatishmërisë së fëmijëve për të nxënë. Në të njëjtën kohë, kurrikulai qartëson nxënësit dhe prindërit e tyre për drejtimin, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënit në shkallë dhe nivele të ndryshme arsimore, të cilat janë bazë për nivelet dhe shkallët pasardhëse. Mësimdhënia dhe nxënia në kurrikulën e reformuar bëhet nëpërmjet situatave kontekstuale të të nxënit, të cilat mbështesin dhe ndihmojnë zhvillimin e kompetencave.

2.1.2 Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë

Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë, konsiderohet si një prioritet i arsimit për të përmirësuar dhe rritur kompetencat profesionale të mësuesit në përshtatje me reformat arsimore, si dhe rritjen e cilësisë së individit për t'u përsosur profesionalisht. Prioritet kryesor është tërheqja dhe mbajtja në punë e mësuesve cilësorë duke i motivuar ata me skema trajnimi dhe kualifikimi, të cilat bazohen në rezultate dhe jo thjesht në vitet e punës.

2.2.Vizioni i DKK

Vizioni i DKK është të hartojë kurrikul që zhvillon te nxënësit kompetencat e të nxënit gjatë gjithë jetës si dhetë fuqizojë zhvillimin profesional të mësuesve për zbatimin e kurrikulës, duke mbështetur, inkurajuar dhe motivuar mësuesit për të rritur standardet profesionale, për të krijuar një klimë që lehtëson mësimdhënien – nxënien dhe duke i bërë nxënësit të jenë efektiv e të suksesshëm në të nxënë.

2.3.Misioni i DKK

Misioni i DKK është që nëpërmjet punës kërkimore dhe hartimit në fushën e kurrikulës si dhe zhvillimit profesional të mësuesve të përmirësojë punën e mësuesve dhe stafeve drejtuese përmes përvojave të përshtatshme të mësimdhënies dhe nxënies, mbështetjes profesionale, gjithëpërfshirjes, kujdesit, frymëzimit, të cilat prevalojnë direkt në zhvillimin e kompetencave lëndore dhe kompetencave kyçe.

2.4.Vlerat drejtuese të DKK

DKK udhëhiqet nga këto vlera drejtuese:

- Ndërmerr iniciativa dhe propozon përmirësime në politikat e fushës së kurrikulës dhe sistemit të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë, të cilat ndikojnë drejt për drejt në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në shkollë.
- Mbështet dhe zhvillon profesionalisht stafet e njësive arsimore vendore dhe të institucioneve arsimore në zbatimin e politikave dhe standardeve bashkëkohore për përmirësimin e cilësisë në shkollë.
- Mësuesit janë bartësit kryesorë të të gjitha ndryshimeve dhe gjithçka varet nga formimi dhe motivimi i tyre.

2.5.Detyrat kryesore të DKK

Detyrat kryesore të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Kualifikimit, në ASCAP janë:

- analizon, zhvillon dhe rishikon dokumentet e rëndësishme si: korniza kurrikulare, programet lëndore, standardet sipas fushave/lëndëve kurrikulare;
- harton dhe boton dokumentet kurrikulare për arsimin parauniversitar;
- harton programe lëndore për të gjitha ciklet (arsimi parashkollor dhe të gjitha klasat 1-12);
- harton dhe boton udhëzues kurrikularë si dhematerialе mbështetëse për zbatimin e kurrikulës në nivel kombëtar;
- harton, analizon dhe rishikon standardet e zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare;
- vlerëson nevojat për zhvillim profesional, programet kombëtare dhe materialet mbështetëse për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
- harton programe kombëtare orientuese për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar;
- organizon zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit parauniversitar;
- menaxhon dhe organizon procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit parauniversitar;
- mbështet funksionimin e rrjeteve profesionale dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm të drejtuesve të këtyre rrjeteve nëpërmjet instrumenteve përkatëse;
- menaxhon procesin e akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
- harton instrumente për vlerësimin e cilësisë së trajnimeve të ofruara nga agjencitë që kanë akredituar programe/module trajnimi për për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
- harton fondin e pyetjeve për testimin kombëtar “Mësues për Shqipërinë” si domosdoshmëri për sigurimin e cilësisë së formimit të mësuesve kandidatë për ushtrimin e profesionit të mësuesit në arsimin parauniverstar;
- realizon punë kërkimore-studimore, analiza periodike dhe u ofron ekspertizë strukturave politike e vendimmarrëse për politikat arsimore dhe reformat në fushën e arsimit parauniversitar;
- ofron këshillim për institucionet arsimore parauniversitare të të gjitha niveleve, në fushat e përmbajtjes kurrikulare, didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe për drejtimin dhe menaxhimin e shkollës dhe arsimit në tërësi;

- bashkërendon veprimtarinë e saj me drejtoritë dhe sektorët e tjerë të ASCAP-it, me ministrinë përgjegjëse për arsimin, si dhe me institucione të tjera të të gjitha niveleve brenda dhe jashtë vendit, për realizimin cilësor të detyrave të saj;
- mundëson dhe mbështet kualifikimin dhe vetëkualifikimin e stafit të drejtorisë;
- bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë apo me organizata kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për veprimtari apo aktivitete që lidhen me detyrat e saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2.6.Objektivat e përgjithshëm të DKK

DKK ka këto objektiva të përgjithshme:

- Të hartojë dhe tërishikojë kurrikulën me standarde europiane dhe më gjerë për zhvillimin e komptencave të të nxënit gjatë gjithë jetës.
- Të organizojë zhvillimin profesional të drejtuesve dhe mësuesve për të përmirësuar cilësinë e procesit të mësidhënie-nxënies.
- Të nxisë arsimin cilësor dhe përmirësimin e gjithpërfshirjes në edukim

2.7.Objektivat e detajuar të DKK

DKK ka këto objektiva të detajuara:

1) Të hartojë materiale ndihmëse për mësuesit nga mësuesit - Përvoja nga praktika e mësuesve me temë "Hartimi i llojeve të pyetjeve bazuar në kompetenca ".
2) Të plotësojë paketën kurrikulare të arsimit parashkollor.
3) Të zbatojë platformën "Një ditë në shkollë" për analizën e vlerësimit të kurrikulës së zbatuar në AML.
4) Të kryejë analizë mbi përputhshmërinë e testeve kombëtare të klasës së IX dhe XII me programet orientuese, sipas kurrikulës me kompetenca (vijon nga 2019).
5) Të hartojë programet orientuese për provimet kombëtare të klasës V-të, IX-të dhe XII/XIII, për vitin shkollor 2020-2021.
6) Të organizohen veprimtarite për hartimin e teksteve të minoritetit.
7) Të organizojë procesin e kualifikimit të mësuesve 2020.
8) Të rishikohen dhe miratohen starndadet profesionale të mësuesit.

9) Të koordinojë punën e KAPT-it për akreditimin e moduleve të trajnimit dhe të portalit të trajnimit.
10) Të mbështesë testimin e informatizuar "Mësues për Shqipërinë" nëpërmjet pjesëmarrjes në komisionet e provimeve.
11) Të zhvillojë kapacitetet e drejtuesve të rrjeteve profesionale në arsimin bazë dhe arsimit të mesëm për punën me udhëzuesit lëndorë me focus të veçantë hartimin e pyetjeve dhe testeve.
12) Të organizohet procesi i identifikimit të nevojave të mësuesve.
13) Të vëzhgojë punën e drejtuesve të rrjeteve si dhe mësuesit e shkencave të natyrës lidhur me zbërthimin e kurrikulës me kompetenca në tekstet angleze.
14) Të zhvillojë kapacitetet e ZVAP-ve dhe DRAP-eve lidhur me udhëzimet e reja për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e mësuesve.
15) Të ngrihen kapacitetet e punonjësve të shërbimit psiko-social dhe oficerëve të sigurisë lidhur me veçoritë e moshës.
16) Të ngihen kapacitetet e mësuesve ndihmës për përmirësimin e përgjegjësive dhe detyrave të tyre.
17) Të koordinojë dhe të organizojë procesin e regjistrimit të mësuesve të gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë.
18) Të organizojë seminarin e përvitshëm mbi programin e integruar të mësimit shqip në diasporë.
19) Të bashkëpunojë me institucionet qendrore, njësitë arsimore vendore, me specialistë të sigurimit të cilësisë dhe me partnerë të tjerë lokalë dhe ndërkombëtarë, për zbatimin e dokumenteve kurrikularë me kompetenca si dhe për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë, për ta zhvilluar shkollën gjithnjë e më shumë në një shkollë në shërbim të komunitetit.

2.8. Realizimi i veprimtarive për DKK (Janar – Dhjetor 2020)

DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMI									
Objektivi i përgjithshëm	**Nr.**	**Objektiva**	**Nr.**	**Tregues**	**Përshkrimi i treguesit**	**Produkt**	**Frekuenca dhe mënyra e matjes**	**Personi përgjegjës**	**Reaalizimi i vepritarive**
Kurrikul me standarde europiane dhe më gjerë për zhvillimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës	1.1	Të hartojë materiale ndihmëse për mësuesit nga mësuesit - Përvoja nga praktika e mësuesve me temë "Hartimi i llojeve të pyetjeve bazuar në kompetenca	1.1.1	Përgatitja e strukturës së materialit	Materiali i përvojave nga praktika e mësuesve do të përmbajë modele pyetjesh bazuar në vlerësimin e kompetencave të hartuara nga vetë mësuesit.	Përcaktimi i strukturës së materialit	Tremujore	**Erida Koleci, Ines Todhe** dhe speciali stët lëndorë	Ka përfudnuar materiali i përgatitur. Jane ngritur grupet e punes dhe po vijon puna per hartimin e materialeve. Përmbyllja e materialit është shtyrë për vitin 2021, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19.
			1.1.2	Ngritja e një grupi mësuesish për përzgjedhjen e testeve që do të përfshihen në manual	Një grup mësuesish do të bëjnë vetë përzgjedhjen e materialeve që do të përfshihen në variantin përfundimtar	10 grupe pune mësuesish sipas profileve lëndore	Gjashtëmujore		
			1.1.3	Përgatija e materialit nga koordinatori i ASCAP dhe Publikimi ne faqe	Koordinatori nga ASCAP sistemon dhe përgatit variantin përfundimtar për publikim	10 dokumente përvojash nga praktika të përgatitura	Vjetore		
	1.2	Të plotësojë paketën kurrikulare të arsimit parashkollor	1.2.1	Standardet e zhvillimit dhe te te nxenit te femijeve 0-3 vjec	Hartohen standardet per zhvillimin dhe te nxenit e femijeve 0.-3 vjec	Standardet e hartuara	Tremujore	**Aurela Zisi, Edlira Sina**	Jane miratuar standardet e zhvillimit dhe te nxenit per femijet 0-3 vjec. Jane trajnuar 65 speciaisteve te
			1.2.2	Udhezues per zbatimin e kurrikules se re ne APSH 3-6 vjec	Hartohet udhezuesi per zbatimin e kurrikules ne arsimin parashkollor	Udfhezuesi I pergatirur	Nëntëmujore		

			1.2.3	Trajnimi i drejtuesve dhe mesuesve te APSH lidhur me paketen kurrikulare 3-6 vjec	Trajnohen drejtuesit e institucioneve, drejtuesit e rrjeteve profesionale, mesuesit per zbatimin e paketes kurrikulare	1100 te trajnuar	Vjetore		bashkive dhe ZVAP per paketen kurrikulare te APSH 3-6 vjec. Janë trajnuar 219 specialistë të ZVA-për paketën kurrikulare. Vijon puna per udhezuesin e APSH edhe gjatë vitit 2021.
			1.2.4	Trajnimi i speciaisteve te bashkive dhe ZVAP per paketen kurrikulare te APSH 3-6 vjec	Trajnohen specialistet qe mbulojne arsimin parashkollor ne bashki dhe ZVAP	100 te trajnuar	Gjashtëmujore		
	1.3	Të zbatojë platformën "Një ditë në shkollë" për analizën e vlerësimit të kurrikulës së zbatuar në AML	1.3.1	Hartimi i platformës së punës "Një ditë në shkollë" dhe treguesit e studimit	Përgatitja e platformës së studimit e cila do të përfshijë fokusin e analizës, fushat e analizës, metodologjinë e realizimit të saj, instrumentet që do të përdoren për vlerësimin e situatës, grupet e punës, afatet	Platforma e punës e përgatitur	Tremujore	**Evis Mastori**, Esion Zgjana, Dorina Rapti	Është hartuar platforma, instrumenti dhe eshte percaktuar kampionimi prej 60 gjimnazesh per vëzhgim. Jane realizuar të gjitha vëzhgimet për zbatimin e kurrikulës në shkollat e mesme. Hartimi i dokumentit të analizës do të realizohet gjatë vitit 2021 dhe u shty për shkak të ngarkesës së punës për shkak të pandemisë.
			1.3.2	Përgatitja e paketës së instrumenteve për mbledhjen e të dhënave.	Përgatitja e paketës së instrumenteve për vlerësimin e ecurisë së zbatimit të kurrkulës me kompetenca.	Instrumente për analizën të përgatitura	Tremujore		
			1.3.3	Përgatitja e analizës mbi bazën e përpunimit të të dhënave.	Përgatitja e analizës me gjetjet dhe rekomandimet sipas fushave.	Analiza e përgatitur	Vjetore		
	1.4	Të kryejë analizë mbi përputhshmërin	14.1	Studimi mbi përputhshmërinë e	Diskutohen me grupe mësuesish, specialistë pershtatshëmria me	Ngrihen 10 grupe	Gashëmujore	**Viola karapici** dhe	Ka përfudnuar

		ë e testeve kombëtare të klasës së IX dhe XII me programet orientuese, sipas kurrikulës me kompetenca (vijon nga 2019).		testeve me programet orientuese	programet lëndore dhe programet orientuese	mësuesish për diskutim		speciali stët lëndorë	
	1.5	Të hartojë programet orientuese për provimet kombëtare të klasës V-të, IX-të dhe XII/XIII, për vitin shkollor 2020-2021	15.1	Hartimi i programeve orientuese për provimet kombëtare të klasës V, IX, XII/XIII	Hartohen programet orientuese të klasës V, IX dhe XII/XIII për vitin shkollor 2019-2020	18 programe orientuese të hartuara	Nëntëmujore	**Ludmilla Stefani** dhe speciali stët lëndorë	20 programe orientuese te MSH te rishikuara per shkak te Covid 19. 24 programe orientuese janë hartuar në shtator per vitin shkollor 2020-2021
	1.6	Të organizohen veprimtarite për hartimin e teksteve të minoritetit	1.6.1	Hartimi i plait të veprimit	Grupet e punës, kontratat, afatet etj	Matrica e veprimtarive	Gjashtëmujore	**Erida Koleci, Ines Todhe** dhe grupi i punës	Ka përfunduar
			1.6.2	Përgatitja e 2 teksteve për MASR	Dorëzimi i materialit të redaktuar, recancat, Gjuha shqipe klasa 5 (greke, maqedonese)	2 Tekstet për miratim	Gjashtëmujore		
Zhvillimi profesional i drejtues	2.1	Të organizojë procesin e kualifikimit të mësuesve 2020.	2.1.1	Përgatitja e databazave për kualifikimin e mësuesve 2020	Përgatitet databaza në nivel kombëtar për kualifikimin e mësuesve	3000 mësues të planifikuar për testim	Tremujore	**Albana Markja, Dorina Rapti**,	Janë hartuar dhe dorëzuar fondet e pyetjeve për 42 lëndë te profileve
			2.1.2	Përgatiten e fondeve sipas profileve/lëndëve	Hartimi i 40 fonde për kualifikimin e mësuesve 2018	40 teste të hartuara	Gjashtëmujore		

ve dhe mësuesve për të përmirësuar cilësinë e procesit të mësidhënie-nxënies.				për kualifikimin e mësusve				Marina Topulli, Viola Karapici, specialistët lëndorë	dhe cikleve të ndryshme. Bazuar ne rezultatet e dërguara nga QSHA, është hartuar raportit të kualifikimit 2020 dhe është dërguar në MASR.
			2.1.4	Përgatitja e raportit përmbledhës	Raporti përfundimtar	Raporti i përfunduar	Vjetore		
	2.2	Të rishikohen dhe miratohen standardet profesionale të mësuesit	2.2	Rishikimi i standardeve profesionale të mësuesve	Diskutimi me mësues i standardeve profesionale të mësuesit	Dërgimi për miratim	Nëntëmujore	**Dorina Rapti, Albana Markja** dhe specialistët lëndorë	Janë hartuar dhe miratuar nga MASR standardet profesionale të mësuesit.
	2.3	Të koordinojë punën e KAPT-it për akreditimin e moduleve të trajnimit dhe të portalit të trajnimit.	2.3.1	Raporti i KAPT dhe trajnimeve nga portali	Hartohet raporti i KAPT per vitin 2019 dhe trajnimet e regjistruara në portal	Raporti i përfunduar	Gjashtëmujore	**Ines Todhe, Gentjana Marku**, Marina Topulli	Është hartuar raporti vjetor i KAPT për vitin 2019 si dhe raporti per trajnimet e realizuara gjatë vitit 2019 dhe është dorëzuar në MASR. Janë koordinuar 5 mbledhje te KAPT gjatë vitit 2020.
			2.3.2	Vlerësimi dhe akreditimi i moduleve të trajnimi nga Komisioni i Akreditimit të Programeve të Trajnimit	Vlerësohen dhe akreditohen modulet e trajnimit të ofruara nga agjencitë trajnuese	100 module të vlerësuara dhe të përgatitura për akreditimin e KAPT-it	Vjetore		
			2.3.3	Koordinimi i monitorimit të trajnimeve nga agjencitë trajnuese	Grupi i monitorimit monitoron agjencitë trajnuese që kryejnë trajnime me punonjësit arsimorë	Agjenci trajnuese të monitoruara	Vjetore		

				nëpërmjet portalit të trajnimeve					
	2.4	Të mbështesë testimin e informatizuar "Mësues për Shqipërinë" nëpërmjet pjesëmarrjes në komisionet e provimeve	2.4.1	Pjesëmarrje në komisionet e testimit "Mësues për Shqipërinë"	Komisionet sipas profileve/lëndëve	Te paktën 25 profie/lëndë	Nëntëmujore	**Dorina Rapti dhe** specialistët lëndorë	Ka përfunduar. ASCAP asistoi në komisionet e testimeve të portalit "Mësues për Shqipërinë", 2020 si dhe në procesin e ankimimeve.
	2.5	Zhvillimi i kapaciteteve të drejtuesve të rrjeteve profesionale në arsimin bazë dhe arsimit të mesëm për punën me udhëzuesit lëndorë (me fokus të vecantë hartimin e pyejeve dhe testeve).	2.5.1	Përgatitja e paketës së materialeve për trajnimin e drejtuesve të rrjeteve profesionale për punën me pyetjet dhe teste.	Përgatitet paketa e materialeve për trajnimin e drejtuesve të rrjeteve profesionale për çështjet që përfshijnë hartimin e pyetjeve dhe testeve.	Materalet e trajnimi	Tremujore	**Albana Markja**, Marina Topulli, Eriksen Mersinllari specialistet të tjerë të drejtorisë	Janë hartuar materialet të trajnimeve dhe eshte pergatitur grafiku I trajnimeve. Aktiviteti I trajnimeve u zhvillua online per shkak te COVID 19. Janë trajnuar 1200 drejtues të rrjeteve profesionale lidhur me udhëzimin e fillim vitit shkollor 2019-2020 si dhe për temat mësimore të hartuara nga ASCAP.
			2.5.2	Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale sipas fushave/lëndëve për punën me udhëzuesit lëndorë me fokus pyetjet dhe testet	Realizohet trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale të arsimit bazë për udhëzuesit lëndorë sipas fushave/lëndëve me fokus hartimin e pyetjeve dhe testeve	Rreth 1200 drejtues të rrjeteve profesionale të trajnuar	Vjetore		
	2.6	Të organizohet procesi i identifikimit të	2.6.1	Hartimi i instrumentit të identifikimit të nevojave	Hartohet instrumenti i identifikimit të nevojave	Instrumenti I përgatitur	Tremujore	**Albana Markja,**	Është përgatitur metodologjia identifikimit të

		nevojave të mësuesve	2.6.2	Mbledhja e të dhënave nga nësuesit	Mblidhen të dhënat nga mësuesit sipas rubrikave të përcaktuara në instrument	Të dhënat	Gjashtëmujore	**Miranda Kurti, Esion Zgjana,** Erksen Mersinllari, Rozeta Hysena, Elfrida Begaj	nevojave, është përgatitur instrumenti i identifikimit të nevojave për zhvillim profesional të mësuesve. Është përgatitur instrumenti online në paltformën google forms. U mblodhen të dhënat nga mësuesit dhe drejtuesit.(Ky proces u zhvillua gjatë muajit nëntor për shkak të situatës së ktijuar nga pandemia COVID 19). Rreth 60% e punonjësve arsimorë kanë plotësuar instrumentin. Raporti përfundimtar i përpunimit të të dhënave do të dorëzohet gjatë vitit 2021.
			2.6.3	Përpunimi i të dhënave	Përpunohen dhe analizohen të dhënat	Përpunimi	Nëntëmujore		
			2.6.4	Hartimi i raportit të identifikimit të nevojave	Hartohet raporti i identifikimit të nevojave	Raporti i përfunduar	Vjetore		
	2.7	Të vëzhgojë punën e drejtuesve të	2.7.1	Përgatitja e kalendarit të vëzhgimeve	Kalendari i vëzhgimeve të takimeve të drejtuesve të rrjeteve dhe mësuesve	Kalendari	Tremujore	**Mimoza Milo, Mirela**	Janë hartuar të gjitha databazat e rregullta te drejtuesve te

		rrjeteve si dhe mësuesit e shkencave të natyrës lidhur me zbërthimin e kurrikulës me kompetenca në tekstet angleze.	2.7.2	Vëzhgimet e drejtuesve dhe mësuesve të shkencave të natyrës	Realizimi i vëzhgimeve në takimet e drejtuesve të rrjeteve dhe mësuesve të shkencave të natyrës"	Vëzhgimet	Vjetore	**Gurakuqi** Elisabeta Paja,	rrjeteve profesionale dhe anetareve te ketyre rrjeteve si dhe jane kryer 4 vezhgime te punes se rrjeteve profesionale te shkencave te natyres (Biologji, Kimi, Fizike). Vijon pune ma vezhgime te tjera Është kryer trajnmi i rreth 110 drejtuesve të rrjeteve profesionale të shkencave të natyrës për mbylljen e vitit shkollor 2020.
	2.8	Të zhvillojë kapacitetet e ZVAP-ve dhe DRAP-eve lidhur me udhëzimet e reja për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e mësuesve.	2.8.1	Organizimi i trajnimeve me specialistët e DRAP, ZVAP per udhezimet e reja te ZHVP dhe Kualifikimit	Trajnohen specialistët e DRAP, ZVAP per udhezimet e reja te ZHVP dhe Kualifikimit	100 specialistë të DRAP dhe ZVAP	Gjashtëmujore	**Dorina Rapti,** Ines Todhe, Marina Topulli	Është kryer trajnimi i 120 specialisteve te ZVAP dhe DRAP per kualifikimin e mesuesve si dhe për zbatimin e udhëzueit të fillim vitit 2020 – 2021. Janë realizuar 2 raunde trajnimesh me specialistet e ZVAP dhe DRAP për udhëzuesin e fillim vitit shkollor si

									dhe për zhvillimin procesit mësimor dhe zbatimin e skenarëve.
Nxitja e arsimit cilësor dhe përmirësimi i gjithpërfshirjes në edukim	3.1	Të ngrihen kapacitetet e punonjësve të shërbimit psiko-social dhe oficerëve të sigurisë lidhur me veçoritë e moshës	3.1.1	Hartimi i materialeve ndihmëse për shërbimin psiko-social	Hartohen materiale ndihmëse që do i shërbejnë procesit të punës së shërbimit psiko-social		Tremujore	**E. Zgjana**	Janë hartuar materialet mbeshtetese per oficeret e siigrise dhe sherbimin psikosocial si dhe eshte hartuar instrumenti I monitorimti te tyre. Janë trajnuar 130 oficere sigurise për zhvillimin e mësimit në kushtet e pandemisë.
			3.1.2	Hartimi i materialeve ndihmëse për oficerët e sigurisë	Hartohen materiale ndihmëse që do i shërbejnë procesit të punës së oficerëve të sigurisë		Tremujore		
			3.1.3	Trajnimi i oficerëve të sigurisë	Trajnimi i 150 oficerëve të sigurisë për materialet e hartuara		Gjashtëmujore		
			3.1.4	Monitorimi dhe vëzhgimi i veprimtarisë së oficerëve të sigurisë	Monitorohen dhe vëzhgohen oficerët e sigurisë mbi punën e tyre		Vjetore		
	3.2	Të ngrihen kapacitetet e mësuesve ndihmës për përmirësimin e përgjegjësive dhe detyrave të tyre	3.2.1	Përgatitja e materialeve/moduleve në ndihmë të mësuesve ndihmës	Përgatitet një paketë modulesh	Paketë e ofruar online	Tremujore	**Albana Markja**	Janë hartuar materiale në mbështetje të mësuesve ndihmës dhe është hartuar databaza e drejtuesve të rrjeteve për mësuesit ndihmës. Janë trajnuar 61 drejtues të rrjeteve për mësuesit ndihmës.
			3.2.2	Ngritja e kapacitetteteve të drejtuesve të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës	Trajnohen 42 drejtues të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës	42 drejtues të rrjeteve te trajnuar	Gjashtëmujore		
			3.2.3	Monitorimi i veprimtarisë së rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës përmes raportimeve	Grumbullim i planeve të rrjeteve dhe vëzhgime të takimeve të rrjeteve	Plane vjetore të grumbulluara, raporte të takimeve të grumbulluara	Vjetore		

				dhe vëzhgimeve në ZVAP					
	3.3	Të koordinojë dhe të organizojë procesin e regjistrimit të mësuesve të gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë	3.3.1	Shpallja për aplikimin e regjistrit të mësuesve të gjuhës shqipenë diasporë	Përgatitja e njoftimit për shpalljen e aplikimit të regjistrit të mësuesve të gjuhës shqipenë diasporë	Njoftimi	Nëntëmujore	**Miranda Kurti** dhe grupi i punës	Është përgatitur shpallja e njoftimit për të gjithë mësuesit e diasporës që duan të regjistrohen në regjistrin e diapsorës. Kanë aplikaur 78 pjesëmarrës. Është dërguar në MASR shkresa përkatëse për miratimin e 23 pjesëmarrësve që plotësojnë kriteret për rregjistrin e diasporës si dhe informacioni për pjesëmarrësit e tjerë.
			3.3.2	Ndjekja e aplikimeve	Ndjekja e aplikimeve	Aplikimet	Vjetore		
			3.3.3	Përgatitja e materialit përmbledhës	Përpunimi i alikimeve dhe përgatitja e materialit	Materiali i përgatitur	vjetore		
	3.4	Organizimi i seminarit të përvitshëm mbi programin e integruar të mësimit shqip në diasporë	3.4.1	Mbështetja e organizimit me Palën e Kosovës	Hartimi i veprimtarive të përbashkëta	Agjenda, zhvillimi i seminarit	Nëntëmujore	**Erida Koleci**, Esion Zgjana	Aktualisht sipas pasoje e situates se krijuar nga COVID 19 nuk u zhvillua seminari mbi programin e integruar të mësimit shqip në diasporë.

2.9.Realizimi i veprimtarive shtesë të DKK - së si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID 19

1. ***Produktet (udhëzues) dhe trajnimet e zhvilluara gjatë periudhës <u>Mars – Qershor 2020</u> për procesin mësimor në kushtet e krijuara nga pandemia COVID – 19***

1.1 Produktet e hartuara në periudhën Mars 2020 – Qershor 2020

Produktet (udhëzues) e zhvilluara gjatë periudhës Mars – Qershor 2020 për procesin mësimor në kushtet e krijuara nga pandemia COVID – 19 mund të përmblidhen si më poshtë:

Produkti	Mars	Prill	Maj	Qershor	Realizuar
Udhëzues për mësimin online në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID-19.					MASR, ASCAP
Udhëzues për realizimin e programit lëndor dhe vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë (ASCAP).					ASCAP
Udhëzues për vlerësimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019 – 2020 (të gjitha ciklet).					MASR, ASCAP
Urdhër për organizimin e mesimit dhe vlerësimin e nxënësve për mbylljen e vitit shkollor për klasën e 12.					MASR, ASCAP
Rishikimi dhe reaktimi i 20 programeve të maturës shtetërore për të gjitha tematikat dhe njohuritë të cilat janë zhvilluar online pas datës 9 mars 2020.					ASCAP
Redaktimi shkencor dhe sigurimi i cilësisë së rreth 500 vidiove të publikuara në Radio Televizionin Shqiptar – Shkolla si dhe në platformën akademi.al					ASCAP
Sondazhi 1 më mësues, nxënës, prindër për zhvillimin e procesit mësimor online, për përdorimin e platformave, pajisjeve digjitale etj.					ASCAP

Sondazhi 2 më mësues, nxënës, prindër zhvillimin e procesit mësimor online, vlerësimin e nxënësve, përdorimin e platformave, pajisjeve digjitale etj.					ASCAP

1.2 ***Trajnimet e zhvilluara Mars 2020 – Qershor 2020 (përfshirë edhe Shkurt 2020)***

Trajnimet e mësuesve për procesin mësimor në kushtet e krijuara nga pandemia COVID -19 u fokusuan më së shumti në trajnimin e udhëzuesve të hartuar nga ASCAP si dhe për përdorimin e platformave të mësimit online. Trajnimet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe përmblidhen si më poshtë:

Tema	Mars	Prill	Maj	Qershor	Realizuar
Trajnime të mësuesve për përdorimin e platformave online TeachPitch zoom, google classroom si dhe për rritjen e aftësive mësimore digjitale.		4000	1508		Kompania TeachPitch, ASCAP
Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale për zbatimin e udhëzuesve të hartuar nga ASCAP lidhur me zhvillimin e mësimit në kushtet e shtëpisë (online)		1180			ASCAP
Trajnimi i specialitëve të ZVA-ve, DRAP-eve për zbatimin e masave të higjienës dhe distancimit fizik për mësimin e zhvilluar me nxënësit e klasave 12-ta (maturantët) në mjedisin e shkollës.			165		ASCAP
Trajnimi i specialitëve të ZVA-ve, DRAP-eve për udhëzuesin e mbylljes së vitit shkollor 2019 -2020.			165		ASCAP, Junior Achievement
Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale lidhur me mbylljen e vitit shkollor 2019-2020 dhe me vlerësimin e nxënësit si dhe për masat anticovid të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Institutit të Shëndetit Publik.			1180		ASCAP
Trajnim i drejtuesve të rrjeteve profesionale për shkencat e natyrës në kuadër të përgatitjes së mësuesve për aftësitë që maten në provimin PISA.				110	ASCAP

Specilistet e ZVA-ve dhe drejtuesve të rrjeteve profesionale për zbatimin e dokumeneteve kurrikulare në arsimin parashkollor	219				ASCAP, UNICEF
Shkollat e shekullit 21. Trajnimi i drejtoreve	246				ASCAP, British Council
Shkollat e shekullit 21. Trajnimi i mësuesve	857				ASCAP, British Council
Nr. i përfituesve në Total	**9630**				

2. ***Produktet (udhëzues) dhe trajnimet që janë zhvilluar gjatë periudhës <u>Korrik – Dhjetor 2020</u> për procesin mësimor në kushtet e krijuara nga pandemia COVID – 19***

2.1 Produktet që janë hartuar gjatë periudhes ***Korrik 2020 – Dhjetor 2020***

Produktet (udhëzues) që *janë hartuar* gjatë periudhës Korrik 2020 – Dhjetor 2020 për procesin mësimor në kushtet e krijuara nga pandemia COVID – 19 mund të përmblidhen si më poshtë:

Produkti	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Realizuar
Hartimi dhe zbatimi i programit të mësimit plotësues në gjuhë shqipe dhe matematikë për klasat 1-5 me nxënësit që paraqitën vështirësi gjatë mësimit të zhvilluar në kushtet e shtëpisë (online) si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID 19.							MASR, ASCAP Save the Children
Planifikimi i temave mësimore të njësuara për të gjitha lëndët dhe klasat 1-12 në kushtet e krijuara nga pandemia COVID 19.							ASCAP

Sondazhi me mësues, nxënës, prindër për fillimin e vitit shkollor 2020 – 2021 në kushtet e krijuara nga pandemia COVID 19.							ASCAP
Hartimi i udhëzuesit për fillimin e vitit shkollor 2020 – 2021 ku janë përfshirë edhe skenarët e mundshëm për zhvillimin e procesit të mësimdhënie – nxënies në kushtet e krijuara nga pandemia COVID 19.							MASR, ASCAP
Hartimi i manualit për përdorimin e platformës **akademi.al** për zhvillimin e mësimit online si dhe mësimet e regjistruara në këtë platformë sipas temave mësimore të hartuara nga ASCAP.							Akademi.al, UNICEF, MASR, ASCAP
Hartimi i standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK në procesin e mësimdhënie – nxënies.							ASCAP, UNICEF
Hartimi i materialeve për plotësimin e Udhëzimit të fillimit të vitit 2020 -2021 në varësi të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.							MASR, ASCAP
Hartimi udhëzuesit për përdorimin e TIK në procesin e mësimdhënie – nxënies.							ASCAP, UNICEF
Hartimi i moduleve të trajnimit për përdorimin e TIK në procesim e mësimdhënie – nxënies që lidhen me lundrimin në internet dhe sigurimi në mjediset digjitale, strategjtë e të nxënit online, vlerësimi i nxënësit online, qytetaria digjitale, përdorimi i aftësive djigjital, zbatimi i standardeve të mësuesit për përdorimin e TIK.							ASCAP, UNICEF

2.2 Trajnimet që janë zhvilluar Korrik 2020 – Dhjetor 2020

Trajnimet e mësuesve për procesin mësimor në kushtet e krijuara nga pandemia COVID -19 janë fokusuar më së shumti në trajnimin e udhëzuesve të hartuar nga ASCAP, për përdorimin e platformave të mësimit online, për vlerësimin e nxënësve si dhe për zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore.

Trajnimet që janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe përmblidhen si më poshtë:

Tema	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Realizuar
Trajnimi i mësuesve, specialistëve të ZVA-ve për zbatimin e programit plotësues për klasat 1-5, në gjuhë shqipe dhe në matematikë, me nxënësit që nuk kanë ndjekur mësimin në distancë gjatë periudhës mars-qershor 2020		106					ASCAP, Save the Children
Trajnim i drejtuesve të rrjeteve profesionale per temat mesimore në kushtet e krijuara nga pandemia COVID 19.			1200				ASCAP
Trajnim i drejtuesve të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës për mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në kushtet e krijuara nga pandemia COVID 19.			38				ASCAP
Trajnim i specialistëve të ZVA-ve për udhëzuesin e fillim vitit shkollor 2020-2021 si dhe për masat anticovid të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Institutit të Shëndetit Publik			67				MASR, ASCAP
Trajnim i mësuesve të TIK për secilën shkollë lidhur me përdorimin e platformës **akademi.al** për zhvillimin e mësimit online, hapjen e klasave virtuale si dhe mësimet e regjistruara në këtë platformë sipas temave mësimore të hartuara nga ASCAP.			1226				Akademi.al, UNICEF, ASCAP
Trajnimi oficerëve të sigurisë për mbështetjen e fëmijëve në kushtet e pandemisë COVID 19.				138			ASCAP

Trajnimi i psikologëve shkollorë për mbështetjen e fëmijëve gjatë situatës së pandemisë COVID 19 si dhe për edukimin seksual.				250			ASCAP
Trajnim i drejtuesve të rrjeteve profesionale për zbatimin e udhëzuesit të fillimit të vitit 2020 – 2021 si dhe për masat anticovid të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Institutit të Shëndetit Publik.			400	800			ASCAP
Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale dhe mësuesve të klasave koletive për fillimin e vitit shkollor 2020 – 2021.			60				ASCAP
Trajnimi i anëtarëve të rrjeteve profesionale për hartimin e planeve të periudhës bazuar në temat mësimore të hartuara nga ASCAP.			10000	10000			ASCAP, drejtuesit e rrjeteve profesionale
Shkollat e shekullit 21. Trajnimi i drejtoreve			112				ASCAP, British Council
Shkollat e shekullit 21. Trajnimi i mësuesve			474				ASCAP, British Council
Trajnim me drejtues të rrjeteve profesionale për vlerësimin bazuar në kompetenca dhe zbatimin e udhëzuesit të hartimit të pyetjeve.				168	168	168	ASCAP, OeAD (ex KulturKontakt)
Trajnim me specialistet e ZVA-ve për zbatimin e procesit mësimor në kushtet e pandemisë COVID 19 dhe monitorimin e këtij procesi.					165		ASCAP
Trajnim me mësuesit e gjuhës angleze dhe të arsimit parashkollor për pilotimin e programit të gjuhës angleze në arsimin parashkollor.					59		ASCAP

Trajnim lidhur me kurrikulën për median dhe informimin duke përfshirë edhe situatën e krijuar nga pandemia COVID 19 si një nga çështjet që sundon në mediat e sotme.					20	15	ASCAP, Instituti Shqiptar i Medias, UNESCO.
Numri i përfituesve në total	**25 634**						

III. DREJTORIA E PERFORMANCËS

Hyrje

Drejtoria e Performancës (DP) është një strukturë e re që funksion në kuadër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). Sigurimi i publikut me informacione të sakta për nivelin e sistemit arsimor parauniversitar në raport me pritshmëritë si formë llogaridhënie dhe rekomandimi i politikave për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit arsimor, janë dy qëllimet kryesore të vlerësimit të performancës së sistemit.

DP do të grumbullojë të dhënat mbi ecurinë e treguesve të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar, të dhëna për gjithëpërfshirjen në arsim dhe zotërimin e kompetencave të të nxënit, që reflektohet në rezultatet e nxënies së nxënësve në vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, të dhëna për procesin e zhvillimit profesional të mësuesve, të dhëna për procesin e digjitalizimit të arsimit dhe të dhëna për mënyrën e funksionimit të institucioneve të arsimit parauniversitar.

Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga raportet zyrtare dhe monitorimit të drejtpërdrejtë, DP do të hartojë raportin e vlerësimit për performancën e sistemit si dhe raporte për mënyrën e funksionimit të institucioneve. Bazuar në analizën e të dhënave DP do të bëjë propozimet përkatëse për hartimin e politikave në funksion të garantimit të performancës së sistemit. Informacioni i saktë dhe kapaciteti i duhur për ta përdorur atë, do të krijojë kushte që Ministria përgjegjëse për arsimin nëpërmjet strukturave të reja të krijuara Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit

Parauniversitar - DPAP dhe strukturave rajonale e vendore të saj, si dhe institucioneve arsimore publike dhe private, të jenë në gjendje të realizojnë qëllimin e politikave të hartuara për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit arsimor.

Shpërndarja e roleve dhe përgjegjësive për vlerësimin e hallkave të sistemit arsimor parauniversitar nuk është gjithmonë e qartë. Në këtë kuptim do të bëhet kujdes që të mos ketë mbivendosje funksionesh dhe as vakum institucional gjatë ushtrimit të përgjegjësive të këtyre institucioneve në funksion të garantimit të performancës së sistemit arsimor.

Raportet vjetore të institucioneve qendrore, rajonale dhe vendore mbi cilësinë e shërbimit arsimor do të jenë të integruara në mënyrë të tillë që të kontribuojë në vlerësimin dhe garantimin e performancës së sistemit në nivel kombëtar.

3.1. Vizioni

Vizioni i DP është garantimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar me në qendër nxënësin, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe konsolidimit e mëtejshëm shoqërisë shqiptare.

3.2. Qëllimi

Për përmbushjen e vizionit të saj, Drejtoria e Përformancës ka si qëllim kryesor vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar, si dhe vlerësimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të institucioneve të arsimit parauniversitar në Shqipëri.

3.3. Vlerësimi i sistemit

Vlerësimi i sistemit është përdorimi i mjeteve të shumëfishta për të zhvilluar një pamje të përgjithshme të performancës arsimore. Kjo gjë e pajis publikun me informacionin e nevojshëm se si po performon sistemi i arsimit, si formë llogaridhënie dhe i pajis hartuesit e politikave me njohurinë e duhur për të ndikuar vendimmarrjet politike.

Fusha e veprimit në procesin e vlerësimit të performances së sistemit përfshin:

Së pari, vlerësimin e nivelit të realizimit të veprimtarive në kuadër të prioriteteve/politikave të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar.

Procesi do të vlerësojë performancën e sistemit arsimor parauniversitar në raport me objektivat e vendosura në Planin Strategjik dhe funksionimin e Planit Strategjik si program afatgjatë për përparimin e prioriteteve kombëtare në fushën e arsimit parauniversitar në kontekstin e zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi.

Së dyti, vlerësimi e mënyrës së organizimit e të funksionimit të sistemit arsimor parauniversitar.

Brenda kësaj fushe procesi do të lidhet me evidentimin e rasteve të mbivendosjes së funksioneve apo me vakumin e krijuar në funksionimin e institucioneve përgjegjëse të arsimit dhe me koordinimin/ndërveprimin reciprok të institucioneve, për të garantuar një nivel të qëndrueshëm integrim ndërinstitucional në funksion të sigurimit të cilësisë.

Mjetet kryesore për vlerësimin e sistemit përfshijnë:

• Treguesit kryesorë që përcaktojnë mbledhjen e informacionit kyç të monitorimit

• Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe analizat e rezultateve

• Vlerësimin e bërë nga programet dhe politikat specifike (OECD, PISA, etj.)

Treguesit e nivelit të sistemit janë të parashikuar në Strategjinë e Sistemit Arsimor Parauniversitar. Me ndryshimet e fundit institucionale, komponentin e të dhënave statistikore për mësuesit, ku përfshihen kualifikimet, përvoja profesionale dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional, do ta zhvillojë ASCAP-i, në përbërje të së cilës është Drejtoria e Performancës. Është e rëndësishme këtu, të krijohet një bashkëpunim cilësor, për të shmangur dublimin e mbledhjes së të dhënave nga institucionet/njësitë arsimore. Të dhënat e vlerësimit do të shërbejnë si të dhëna për DP për analiza të zgjeruara të rezultateve të nxënësve.

Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare të nxënësve

3.3.1. Vlerësimet kombëtare

Vlerësimet kombëtare në Shqipëri kryhen në tre nivele:

- Vlerësimi kombëtar i klasave të pesta;
- Vlerësimi kombëtar i klasave të nënta-Provimi i Lirimit;
- Matura Shtetërore.

Këto vlerësime kryhen nga MASR nëpërmjet testeve të përgatitura nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, QSHA.

Gjithashtu vlerësimi i jashtëm lidhur me zbatimin e kurrikulës do të kryhet nga Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë, ndërsa problemet e ligjshmërisë do të zgjidhen nga DPAP-ja.

Institucionet arsimore, bazuar në kurrikulën e re me bazë kompentencat, kryejnë vlerësimet e brendshme të nxënësve në tri periudha tre mujore të ndarë në tre komponentë: vlerësimi i vazhduar, vlerësimi me test dhe vlerësimi i punës së pavarur (portofol). Bazuar në arritjet vjetore të këtyre komponentëve kryhet vlerësimi përfundimtar vjetor i nxënësit për çdo lëndë.

3.3.2. Vlerësimet ndërkombëtare

Përveç këtyre vlerësimeve, Shqipëria merr pjesë në Programin për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA). Ajo ka marrë pjesë në PISA 2000, 2009, 2012, 2015 dhe 2018. Megjithë përmirësimet në renditje, rezultatet janë akoma larg mesatares së vendeve të OECD.

Vlerësimet nga programet/politikat specifike

DP do të analizojë treguesit për raportin e përgjithshëm të performancës së arsimit dhe do të do të jetë një burim i rëndësishëm i kapacitetit analitik në sistemin arsimor. Në këtë kuadër DP do të analizojë efektshmërinë e pjesëmarrjes dhe rezultatet e arritura në PISA 2018. DP do të vlerësojë rezultatet në raport me pritshmëritë dhe do të japë propozimet përkatëse për MASR. DP do të bëjë krahasimin e rezultateve të nxënësve shqiptarë në PISA me rezultatin mesatar të vendeve të OECD dhe do të japë propozimet përkatëse. Në vlerësimin e programeve dhe partneriteteve një rol të rëndësishëm luan dhe INSTAT i cili kontribuon me analizat për sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet sistemi arsimor i Shqipërisë.

3.3.3. Dokumentet e vlerësimit

Drejtoria e Performancës do të kryejë vlerësimin dhe garantimin e performancës së sistemit arsimor. ASCAP do të prodhojë raportin e përgjithshëm të performancës së sistemit të arsimit në nivel kombëtar me këshillimet përkatëse për MASR dhe institucionet e varësisë, institucionet arsimore dhe grupet e partneritetit/interesit.

Për ta realizuar në mënyrë profesionale këtë vlerësim ASCAP, nëpërmjet Drejtorisë së Performancës, do të hartojë dokumentat bazë të vlerësimit ku përfshihen:

-Manuali i Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar

-Metodologjia e Vlerësimit së Sistemit Arsimor Parauniversitar

-Manuali i Vlerësimit të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar

- Metodologjia e Vlerësimit të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar.

Si hap i parë do të jetë përfundimi i hartimit të dy dokumentave: Manualit të Vlerësimit dhe Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar. Për këtë janë shfrytëzuar modelet dhe do të shfrytëzohen përvojat më të mira ndërkombëtare.

3.4. Detyrat kryesore të Drejtorisë së Performancës

DP kryen detyrat, si më poshtë:

a) vlerëson performancën e sistemit arsimor parainuversitar, efektshmërinë dhe eficencën e masave, si dhe përmbushjen e objektivave;

b) vlerëson mënyrën e organizimit e të funksionimit të sistemit arsimor parauniversitar dhe merr masat e nevojshme në rast mbivendosjesh funksionesh ose mungese ekzekutimi të detyrave funksionale nga instucionet përgjegjëse;

c) vlerëson se si institucionet e varësisë ndërlidhen/koordinohen/ndërveprojne me njëri tjetrin, duke garantuar nivelin e duhur të integrimit për sigurimin e arsimit parauniversitar cilësor;

d) vlerëson gjendjen e mjedisit fizik/infrastrukturës dhe mjaftueshmërinë e burimeve, duke propozuar edhe masat e nevojshme;

e) kryen analiza të ndryshme mbi bazën qendrore e të integruar të të dhënave të sistemit të arsimit parauniversitar dhe shpërndan informacionin;

f) harton dhe siguron zbatimin e manualeve dhe metodologjive arsimore, në funksion të vlerësimit të performancës së sistemit.

g) bashkërendon veprimtarinë e saj me drejtoritë dhe sektorët e tjerë të ASCAP, me ministrinë përgjegjëse për arsimin si dhe me institucione të tjera të të gjitha niveleve brenda dhe jashtë vendit, për realizimin cilësor të detyrave të saj;

h) mbështet kualifikimin dhe vetë-kualifikimin e stafit të drejtorisë.

3.5. Objektivat e përgjithshëm të Drejtorisë së Performancës

Objektivat e përgjithshëm të DP janë:

1. Vlerësimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar.
2. Garantimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar.
3. Vlerësimi i mënyrës së organizimit e të funksionimit të institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar.

3.6. Objektivat e detajuar

Objektivat e detajuar janë si më poshtë:

1. Hartimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar.
2. Hartimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar.
3. Hartimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, qendrore, rajonale dhe vendore.
4. Hartimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, qendrore, rajonale dhe vendore
5. Mbledhja dhe analiza e të dhënave të sistemit të arsimit parauniversitar mbi bazën qendrore e të integruar dhe dhënia e informacionit.
6. Vlerësimi i efektivitetit dhe eficencës së shërbimit psiko-social të ofruar në sistemin parauniversitar.
7. Vlerësimi i efektshmërisë dhe eficiencës së shërbimit të oficerëve të sigurisë në shkolla.
8. Vlerësimi i efektshmërisë dhe eficiencës së masave të marra dhe rekomandimet përkatëse në funksion në realizimit të objektivave të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar.
9. Monitorimi dhe Vlerësimi se si institucionet qendrore dhe rajonale ndërlidhen/ koordinohen/ ndërveprojnë me njëri tjetrin, duke garantuar nivelin e duhur të integrimit për sigurimin e arsimit parauniversitar cilësor.
10. Vlerësimi i gjendjes së mjedisit fizik/infrastrukturës dhe mjaftueshmëria e burimeve në institucionet arsimore, duke propozuar edhe masat e nevojshme.

3.7. Veprimtaritë e DP

Për realizimin e objektivave DP do të zhvillojë veprimtaritë si më poshtë:

3.7.1. Hartimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës

- Ngritja e grupit të punës për hartimin e Manualit të Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar.
- Përcaktimi i strukturës së Manualit të Vlerësimit të Performancës
- Hartimi i draftit paraprak të Manualit.
- Diskutimi draftit të Manualit me specialistët dhe grupet e interesit.
- Hartimi i draftit Përfundimtar të Manualit

3.7.2. Hartimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës

- Ngritja e grupit të punës për hartimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës
- Përcaktimi i strukturës së Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës
- Hartimi i draftit paraprak të Metodologjisë.
- Diskutimi draftit të Metodologjisë me specialistët dhe grupet e interesit.
- Hartimi i draftit Përfundimtar të Metodologjisë

3.7.3. Hartimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, qendrore rajonale dhe vendore

- Ngritja e grupit të punës për hartimin e Manualit të Vlerësimit të Performancës së Institucioneve
- Përcaktimi i strukturës së Manualit për e institucioneve
- Vazhdimi i punës për hartimin e draftit

3.7.4. Vlerësimi i masave të marra

- Pyetësor me të gjithë punonjësit e shërbimit psiko-social që ofrojnë shërbimin në sistemin arsimor parauniversitar.
- Raport për vlerësimin e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare.
- Pyetësor me të gjithë oficerët e sigurisë që ofrojnë shërbim në shkolla

- Pyetësor me fokus-grupe nxënësish për sigurinë në shkolla.
- Përpunimi i të dhënave

3.7.5. Pilotimi i Draftit të Manualit (Prioriteti D i strategjisë së vjetër)

- Mbledhja dhe analiza e të dhënave për kualifikimin e mësuesve.
- Mbledhja dhe analiza e të dhënave për trajnimet e mësuesve.
- Raport vlerësimi pjesor lidhur me nivelin e realizimit të veprimtarive për zhvillimin profesional të mësuesve.

3.7.6. Studime

- Studim "Mbi praktikat më të mira ndërkombëtare të menaxhimit të sistemit arsimor gjatë periudhës Covid-19.

3.8. Realizimi i veprimtarive për DP për periudhën 01 Janar - 31 Dhjetor 2020

DREJTORIA E PERFORMANCËS									
Objektivi i përgjithshëm	**Nr.**	**Objektiva**	**Nr.**	**Tregues**	**Përshkrimi i treguesit**	**Produkt**	**Frekuenca dhe mënyra e matjes**	**Personi përgjegjës**	**Realizimi i vepritarive**
-Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të performancës së	1.1	Diskutimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar me grupet e	1.1.1	Diskutimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar me grupet e interesit.	Manuali i Vlerësimit të Performancës do të diskutohet me grupet e interesit, nga ku do të reflektohen vërejtje dhe sugjerime të arsyeshme për përmirësim të dokumentit.	Manuali i Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor.	3 mujore	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Ka përfunduar manuali i Vlerësimit të Performancës . Është diskutuar me: dy drejoritë e ASCAP-i, DPAP, DRAP-et. Komentet dhe sugjerimet

sistemit arsimor parauniversitar, publik dhe privat.		interesit dhe ekspert të fushës.							janëreflektuar në dokument.
			1.1.2	Diskutimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar me ekspertë të fushës.	Manuali i Vlerësimit të Performancës do të diskutohet me ekspertë të fushës, nga ku do të reflektohen vërejtje dhe sugjerime të arsyeshme për përmirësim të dokumentit.		3 mujore	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Është bërë kërkesë pranë UNICEF për mbështetje me ekspert të huaj, por për shkak të situatës COVID-19 ka qenë e pamundur.
			1.1.3	Pilotimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar.	Manuali i Vlerësimit të Performancës do të pilotohet për disa tregues.		6 mujore	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Janë pilotuar disa objektiva të prioritetit D të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020
			1.1.4	Hartimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar.	Pas pilotimit, reflektimit të përmirësimeve në të, miratimit nga MASR-ja, Manuali do të publikohet.		8 mujore		Manuali është dërguar në MASR për vërejtje ose sugjerime te fundit. Do të miratohet si paketë bashkë me Metodologjinë.
	1.2	Hartimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës	1.2.1	Përcaktimi i strukturës së Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së	Ngritja e grupit të punës për dhe konsultimi i përvojave të ndryshme për Metodologjinë e Vlerësimit të Performancës	Vendim për ngritjen e grupeve të punës.	3 mujore	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Është ngritur grupi i punës, i cili konsultoi dhe përzgjodhi përvojat më të

		së sistemit arsimor.		sistemit arsimor parauniversitar.	së sistemit arsimor parauniversitar.				mira për hartimin e Metodologjisë të Vlerësimit së Performancës në sistemin arsimor parauniversitar.
			1.2.2	Hartimi i draftit paraprak te Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar.	Përcaktimi i strukturës së Metodologjisë. Tryeza, takime, diskutime në grup për modelet pozitive dhe strukturën e metodologjisë.	Struktura e Metodologjisë Raporte informimi për diskutimet në grup.	6 mujore	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Është përzgjedhur struktura e Metodologjisë e cila është në zbatim të Manualit të Performancës.
			1.2.3	Konsultimi i Draftit te Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar.	Metodologjia e Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar.	Draft-Metodologjia	8 mujore	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Është hartuar draft Metodologjia e Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar.
			1.2.4	Diskutimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar me grupet e interesit.	Metodologjia e Vlerësimit të Performancës do të diskutohet me grupet e interesit, nga ku do të reflektohen vërejtje dhe sugjerime të arsyeshme për përmirësim të dokumentit.	Reflektimi i komenteve/ sugjerimeve nga grupet e interesit dhe ekspertët.	9-12 mujore	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Për shakak të pandemisë Covid-19, diskutimi është bërë në grupë të vogla. Ka perfunduar
			1.2.5	Diskutimi i Metodologjisë të	Metodologjia e vlerësimit të performancës do të diskutohet		9-12 mujore	**Bashkim Muça** dhe	Për shakak të pandemisë Covid-

				Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar me ekspertë të fushës.	me ekspertë të fushës, nga ku do të reflektohen vërejtje dhe sugjerime të arsyeshme për përmirësim të dokumentit			specialistët e drejtorisë	19, diskutimi është bërë në grupë të vogla Ka perfunduar
			1.2.6	Pilotimi i Metodologjisë së Vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar.	Metodologjia e Vlerësimit të Performancës do të pilotohet, për prioritete të veçanta të strategjisë.	Metodologjia	Vjetore	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Do të fillojë pasi të përfundojë hartimi i Strategjise se Re 2020-2025
			1.2.7	Miratimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së sistemit arsimor parauniversitar.	Pas pilotimit, reflektimit në të, të ndryshimeve të mundshme, miratimit nga MASR-ja, Metodologjia do të publikohet.		Vjetore	**Bashkim Muça**	Do të realizohet ne pakete me Manualin pas miratimit nga MASR
	1.3.	Hartimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës	1.3.1	Përcaktimi i strukturës së Manualit të Vlerësimit të Performancës së Institucioneve te Arsimit Parauniversitar.	Ngritja e grupit të punës për dhe konsultimi i modeleve te Manualit të Vlerësimit të Performancës së Institucioneve te Arsimit Parauniversitar	Vendim për ngritjen e grupeve të punës. Përcaktimi i strukturës.	Tetor-Nëntor 2020	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Është ngritur grupi i punës, i cili ka konsultuar modelet ekzistuese më të mira për hartimin e Manualit
			1.3.2	Hartimi i draftit paraprak te Manualit të Vlerësimit të Performancës së	Përcaktimi i strukturës së Manualit. Tryeza, takime, diskutime në grup të vogla në kushtet e	Struktura e Manualit të Vlerësimit të Performancës	Nëntor - Dhjetor 2020	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Është hartuar drafti paraprak i Manualit të Vlerësimit të

		së Institucioneve te Arsimit Parauniversitar, qendrore, rajonale dhe vendor		Institucioneve te Arsimit Parauniversitar	Covid-19, për modelet e përshtatshme.	së Institucioneve te Arsimit Parauniversitar			Performancës së Institucioneve te Arsimit Parauniversitar
			1.3.3	Diskutimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së Institucioneve te Arsimit Parauniversitar me grupet e interesit.	Manualit i Vlerësimit të Performancës së Institucioneve te Arsimit Parauniversitar, do të diskutohet me grupet e interesit, nga ku do të reflektohen vërejtje dhe sugjerime të arsyeshme për përmirësim të dokumentit.	Reflektimi i komenteve/ sugjerimeve nga grupet e interesit dhe ekspertët.	Dhjetor 2020-Mars 2021	**Bashkim Muça** dhe specialistët e drejtorisë	Për shakak të pandemisë Covid-19, diskutimi do të bëhët me grupe të vogla dhe online.
Vlerësimi dhe garantimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar, publik dhe privat	2.1	Mbledhja dhe analiza e të dhënave të sistemit të arsimit parauniversitar mbi bazën qendrore e të integruar dhe dhënia e informacionit	2.1.1	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave në funksion të vlerësimit të performancës për prioritetin e Zhvillimit Profesional	Mbledhja e të dhënave për kualifikimin dhe trajnimin e mësuesve dhe pilotimi i vlerësimit të prioritetit, bazuar në treguesit e strategjisë ekzistuese	Raport vlerësimi për pilotimin	Vjetore	**Ermal Kola Adela Iljazi Albina Nuredini ErjolaShehaj**	Janë mbledhur të dhënat dhe është realizuar një raport edhe në kuadër të objektivut strategjik D.
			2.1.2	Vlerësimi i performancës për disa nga objektivat e vendosura për realizimin prioritetit të Zhvillimit Profesional	Bazuar në të dhënat e përpunuara Sektori i Garantimit të Performancës në bashkëpunim me Sektorin e Statistikës, ka bërë vlerësimn e performancës për	Raport vlerësimi për pilotimin	9 mujore	**Mirela Kondili** **Etleva Lundra**	Ka përfunduar pilotimi i vlerësimit të performancës për 3 objektiva të prioritetit D.

					disa nga objektivat e prioritetit D.			**Lindita Cifci**	
	2.2	Vlerësimi i efektshmërisë dhe eficiencës së masave të marra dhe rekomandimet përkatëse në funksion në realizimit të objektivave të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020.	2.2.1	Vlerësimi i eficiencës së vendosjes së oficerëve të sigurisë në disa shkolla.	Monitorimi dhe vlerësimi i eficencës së oficerëve të sigurisë në gjimnaz	Raport vlerësimi	12 mujore	**Lindita Çifçi** **Mirela Kondili** dhe sektori i statistikave	Si pasoje e situatës së krijuar nga COVID-19, është zhvilluar sondazhi online me nxënësit dhe ogicerët e sigurisë dhe po vazhdon përpunimi i të dhënave.
			2.2.2	Vlerësimi i eficiencës së funksionimit të institucioneve si "Shkolla Qendër Komunitare".	Monitorimi dhe vlerësimi i eficencës të shkollave "Qendër komunitare".	Raport vlerësimi	12 mujore	**Etleva Lundra** **Mirela Kondili** dhe sektori i statistikave	Si pasoje e situatës se agravuar nga COVID-19 ky tregues do të zhvillohet në vitin 2021, sepse përfshin monitorimin e drejtpërdrejtë.
			2.2.3	Vlerësimi i efektshmërisë së iniciativës "Bëjmë detyrat e shtëpisë" .	Monitorimi dhe vlerësimi i efektshmërisë së iniciativës "Bëjmë detyrat e shtëpisë" .	Raport vlerësimi	6 mujore	**Etleva Lundra** **Lindita Çifçi** dhe sektori i statistikave	Si pasoje e përfundimit te fazës se pare te kësaj iniciative ky tregues shtyhet per nje periudhe tjetër, sepse përfshin monitorimin e drejtpërdrejtë.

			2.2.4	Vlerësimi i efektivitetit dhe eficencës së shërbimit psiko-social të ofruar në sistemin parauniversitar.	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga Sektori i Statistikës, lidhur me shërbimin psiko-social	Analiza dhe përpunimi statistikor i të dhënave	6 mujore	**Redi Dengeri** **Ermal Kola** **Adela Iljazi** **Erjola Shehaj** **Albina Nuredini**	Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 ZVAP dhe psikologët kanë dorëzuar të dhënat e pyetësorëve në muajin korrik 2020.
			2.2.5	Vlerësimi i efektivitetit dhe eficencës së shërbimit psiko-social të ofruar në sistemin parauniversitar.	Vlerësimi i të dhënave nga Sektori i Statistikës, lidhur me shërbimin psiko-social	Raport vlerësimi	9 mujore	**Bashkim Muca** **Mirela Kondili** **Etleva Lundra** **Lindita Cifci**	Raporti i përfunduar

3. COVID - 19	3.1	Objektiv shtesë si pasojë e situatës së krijuar nga COVID-19.	3.1.1	Është bërë një studim mbi situatën arsimore në botë si pasojë e COVID-19. Janë marrë në studim përvojat më të mira të shteteve evropiane. Studimi është mbështetur në përvojën e 180 vendeve sipas Bankës Botërore dhe UNESCOS.	Hartimi i Raportit të studimit mbi përvojat më të mira të marra nga Banka Botërore dhe UNESCO.	Raporti i studimit	3 mujore	**Bashkim Muca** Specialistët e drejtorisë	Raporti i perfunduar
			3.1.2	Monitorimi i videove për lëndët Dituri e Natyrës dhe Gjuhë Shqipe e Lëtërsi	Monitorimi i mësimit online	Redaktimi i materialeve PP	Gjatë periudhës së të mësuarit online	**Etleva Lundra**	Raportimi për monitorimin e të mësuarit online

IV. DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË

4.1 Gjendja aktuale

Drejtoria e vlerësimit të cilësisë funksionon si pjesë përbërëse e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimit Parauniversitar (ASCAP) është krijuar në përputhje me VKM nr. 98 datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë

në Arsimin Parauniversitar". Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë (DVC), ka në fokusin e saj monitorimin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, publik dhe privat, si dhe programet e tyre mësimore, në bashkërendim me drejtoritë e tjera të ASCAP-it. Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë ka qenë dhe mbetet një ndër sfidat e përhershme të sistemeve arsimore, në kushtet e ndryshueshmërisë në kohë të konceptimit të saj, nëpërmjet udhëzuesve/protokolleve të përmirësuara dhe të përditësuara të cilat e definojnë objektivisht atë.

3.3.1 Vlerësimi i cilësisë së kurrikulës

Kurrikula e reformuar, mbështetur në qasjen me kompetenca po zbatohet në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar. Monitorimi dhe vlerësimi mbi bazë risku i DRAP-eve, ZVAP-ve dhe IAP-ve, është ndër kushtet e vijimit të suksesshëm të saj, duke realizuar edhe punë kërkimore-studimore, analiza periodike, të cilat mundësojnë ofrimin e ekspertizës për strukturat politike vendimmarrëse dhe për reformat në fushën e arsimit parauniversitar. Monitorimi dhe vlerësimi në vijimësi i zbatimit të kurrikulës në lloje, nivele dhe cikle të ndryshme shkollimi, i kushteve dhe detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor të institucioneve, apo gjithë sistemit arsimor parauniversitar për kurrikulën, standardet, metodologjinë, mundëson përmirësimin e sistemit nëpërmjet këshillimeve dhe rekomandimeve në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Udhëzuesit/protokollet e hartuara dhe të përditësuara nga Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë sigurojnë progresin e performancës së DRAP-eve, ZVAP-ve, IAP-ve publike dhe private nëpërmjet zbatimit të vlerësimit të jashtëm dhe vlerësimit të brendshëm.

3.3.2 Organizimi dhe drejtimi i institucioneve arsimore

Organizimi, drejtimi, bashkëpunimi institucional dhe ndërinstitucional, është risi që mundëson realizimin e misionit, detyrave dhe përgjegjësive të secilit për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së IAP-ve dhe sistemit si i tërë.
Organizimi dhe drejtimi i institucioneve arsimore, duhet të jetë në vëmendje të përhershme të monitorimit dhe vlerësimit për vetë impaktin që përcjell në perfomancën e institucioneve arsimore publike dhe private, nëpërmjet punëve kërkimore-studimore dhe analizave periodike.

4.2 Vizioni

Vizioni i DVC-së është përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar në sistemin arsimor parauniversitar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), nëpërmjet zbatimit të udhëzuesve/protokolleve bashkëkohore, kontekstuale në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.3 Misioni

Misioni i DVC-së është monitorimi dhe vlerësimi i sigurimit të cilësisë në sistemin arsimor parauniversitar, duke hartuar udhëzuesit/protokollet përkatëse vlerësuese në mbështetje të procesit të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të IAP-ve publike dhe private, nëpërmjet një pune kërkimore-studimore, analizave periodike për një vlerësim objektiv në bazë të regjistrit të riskut.

4.4 Vlerat drejtuese

DVC-ja udhëhiqet nga këto vlera drejtuese:

- "Agjent i ndryshimit" për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar, nëpërmjet vlerësimit, raportimit, këshillimit, në bazë të parimeve të proporcionalitetit, paanshmërisë, pavarësisë, për arritjen e qëllimit të sistemit arsimor parauniversitar në përputhje me strategjinë e SAPU-së;
- Ndërmerr iniciativa dhe propozon përmirësime në politikat për monitorimin e vlerësimin e cilësisë, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në performancën e shkollës dhe sistemit arsimor në tërësi duke përzgjedhur dhe përhapur praktika të suksesshme;
- Mbështet profesionalisht stafet e DPAP-së, DRAP-ve, ZVAP-ve dhe të institucioneve arsimore në zbatimin e udhëzuesve/protokolleve të vlerësimit të jashtëm dhe vlerësimit të brendshëm në IAP-ve publike dhe private;
- Mbështet profesionalisht drejtimin dhe organizmin e shkollës si element kyç në përmirësimin e performancës së saj.

4.5 Detyrat kryesore të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë

Detyrat kryesore janë:

a) harton, analizon dhe rishikon udhëzuesit e inspektimit, monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së institucionit përgjegjës për arsimin për ofrimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar si dhe të institucioneve arsimore publike dhe private mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
b) vlerëson dhe monitoron mbi bazë risku veprimtarinë e institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar, për respektimin në vazhdimësi të kushteve dhe detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor, shoqëruar me lënien e detyrave/sugjerimeve/rekomandimeve për përmirësimin e elementeve të caktuar të institucioneve apo gjithë sistemit të arsimit parauniversitar, si: kurrikul, standarde, metodologji, drejtim institucioni etj;
c) vlerëson dhe monitoron mbi bazë risku veprimtarinë e institucioneve arsimore publike dhe private të sistemit të arsimit parauniversitar, për respektimin në vazhdimësi të kushteve dhe detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor, shoqëruar me lënien e detyrave/sugjerimeve/rekomandimeve për përmirësimin e elementëve të caktuar të institucioneve apo gjithë sistemit të arsimit parauniversitar, si: kurrikul, standarde, metodologji, drejtim institucioni etj;
d) monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës në lloje, nivele e cikle të ndryshme shkollimi;

e) kontrollon përputhshmërinë me ligjin për veprimtaritë e agjencive trajnuese ose të organizatave që ofrojnë trajnime për punonjësit arsimorë;
f) vlerëson cilësinë e trajnimeve të ofruara nga agjencitë që kanë akredituar programe/module trajnimi për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
g) këshillon dhe jep rekomandime për njësitë vendore arsimore dhe për institucionet arsimore, në lidhje me përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor;
h) përzgjedh dhe përhap praktikat e suksesshme të institucioneve arsimore nëpërmjet faqes zyrtare të ASCAP-it ose botimeve;
i) informon dhe raporton nëpërmjet raporteve të vlerësimit të cilësisë, letrave informuese, komunikimit on-line dhe botimeve, ministrin përgjegjës për arsimin, institucionet e varësisë së ministrisë për arsimin, njësitë vendore arsimore, bashkitë për shkollat që kanë nën juridiksion, institucionet arsimore.
j) kontribuon në formulimin ose në rishikimin politikave dhe të strategjive arsimore, si dhe në vendimmarrjet në fushën e reformave arsimore, mbi bazën e gjetjeve dhe informacioneve nga monitorimet;
k) bashkëpunon me drejtoritë e tjera të ASCAP-it në funksion të përmbushjes me cilësi të qëllimeve dhe të funksioneve të ASCAP-it;
l) mundëson dhe mbështet kualifikimin dhe vetë-kualifikimin e stafit të drejtorisë;
m) bashkëpunon me organizata kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për veprimtari apo aktivitete që lidhen me detyrat saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

4.6 Objektivat e përgjithshëm për periudhën janar-dhjetor 2020

DVC-ja ka këto objektiva të përgjithshme:

- Hartim i produkteve për vlerësimin e Institucioneve Arsimore Parashkollore, ZVAP-ve, metodologjisë së riskut, rishikimi i KPSH-së, hartimi i fishave të kontrollit për vlerësimin e zbatimit të "Rregullores për administrimin e sistemit Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"
- Vlerësim i zbatimit të KPSH-së, cilësisë menaxhimit të shkollës dhe kurrikulës s ë zbatuar në fushën shkencës, IT.
- Ngritja e kapaciteteve të DPAP/DRAP/ZVAP-ve, për vlerësimin e institucioneve arsimore parauniversitare.

4.7 Objektivat e detajuar për periudhën qershor-dhjetor 2020

DVC-ja ka këto objektiva të detajuar:

1. Hartimi i udhëzuesit "Vlerësimi i jashtëm i institucioneve të arsimit parashkollor";
2. Hartimi i manualit të "Rregjistrit të riskut të institucioneve të arsimit parauniversitar";
3. Rishikimi i treguesve të Kartës së Performancës së Shkollës mbështetur në përditësimin e kornizës ligjore dhe zhvillimeve në sistem;

4. Hartimi i fishave të kontrollit për vlerësimin e zbatimit të “Rregullores për administrimin e sitemit Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;
5. Hartimi i raportit të vlerësimit për zbatimin e Kartës së Perfomancës së Shkollës;
6. Vlerësimi i cilësisë së menaxhimit të shkollës;
7. Vlerësimi i kurrikulës së zbatuar në fushën shkencës (lëndët: fizikë, kimi, biologji);
8. Vlerësim i kurrikulës së zbatuar në IT;
9. Ngritja e kapaciteteve/ mentorimi i DPAP/DRAP/ZVAP-ve për vlerësimin e jashtëm të institucioneve arsimore parauniversitare dhe pilotimi i “Udhëzuesit për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës”;
10. Ngritja e kapaciteteve/ mentorimi i DPAP/DRAP/ZVAP-ve për vlerësimin e brendshëm të institucioneve arsimore parauniversitare dhe pilotimi i “Metodologjisë për vlerësimin e brendshëm të shkollës”;
11. Hartimi i platformave për vlerësimin e aspekteve te ndryshme të shkollës;
12. Mentorimi i procesit të vlerësimit të DRAP-ve për platformat e vlerësimit të hartuara nga DVC-ja.

4.8 Tabela e veprimtarive të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË										
Nr.	**Objektivi i përgjithshëm**	**Nr.**	**Objektiva të detajuara**	**Nr.**	**Tregues**	**Përshkrimi i treguesit**	**Produkt**	**Frekuenca dhe mënyra e matjes**	**Personi përgjegjës**	**Realizimi i veprimtarive**
1.	Finalizimi i produkteve për vlerësimin e shkollës.	**1.1**	Pilotimi i dokumenteve për vlerësimin e cilësisë së shkollës dhe trajnimi dhe mentorimi i specialistëve të DPAP-	**1.1.1**	Tryeza të rrumbullakëta për konsultimin e dokumenteve.	Konsultimi i 4 dokumenteve të hartuara nga periudha qershor 2019-Dhjetor 2019: a) Korniza e vlerësimit të cilësisë së shkollës; b) Udhëzuesi për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës; c) Metodologjia për vlerësimin e jashtëm të shkollës;		100%	T. Çobaj, E. Veli, I. Sina, M. Ucaj, Sh. Muça,	U organizuan tryeza të rrumbullakëta për konsultimin e paketës së vlerësimit të shkollës me specialistë të DPAP-ë dhe 4 DRAP-eve.

			së, DRAP-eve dhe ZVAP-eve për zbatimin e tyre.			d) Metodologjia për vlerësimin e brendshëm të shkollës.				
				1.1.2	Përcaktimi i metodologjisë për ngritjen e kapaciteteve dhe pilotimin e dokumenteve.	Metodologjia do orientohet në tri aspekte: a) Trajnimin e inspektorëve, specialistëve rajonalë/lokalë, drejtuesve të shkollave; b) Metodologjinë për pilotimin e shkollave; c) Vlerësimin e pilotimit dhe vlerësimin e shkollave.	Hartimi i metodologjisë së ngritjes së kapaciteteve dhe pilotimit.	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça	U hartua metodologjia e ngritjes së kapaciteteve dhe pilotimit
				1.1.3	Hartimi i moduleve të trajnimit.	Grupet e punës përgatisin modulet për 4 dokumentet: a) Kornizën e vlerësimit të cilësisë së performancës së shkollës; b) Udhëzuesin e vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës; c) Metodologjinë për vlerësimin e jashtëm të shkollës; d) Metodologjia për vlerësimin e brendshëm.	Modulet e trajnimit. Pyetësorët para dhe pas trajnimit.	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça	U hartuan modulet e trajnimit.
				1.1.4	Trajnimi i DPAP-së, DRAP-eve, ZVAP-eve dhe drejtuesve të shkollave.	Veprimtari trajnuese me specialistët e DPAP-së, DRAP-ve, ZVAP-së dhe drejtues shkollash për 4 produktet e hartuara.	Databaza e trajnimit dhe gjetjet e dala nga pyetësorët e para dhe pas trajnimit.	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça	U zhvilluan trajnime me specialistë të DPAP-së DRAP-eve dhe ZVAP-ve, si dhe me drejtues shkollash për 4 produktet e hartuara.

				1.1.5	Mentorimi i procesit të paravlerësimi t të shkollës.	Analizimi i të dhënave të dërguara nga shkollat të cilat do ti nënshtrohen procesit të vlerësimit të plotë të tyre nëpërmjet "Udhëzuesit për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës" .	Platforma e vlerësimit të plotë të shkollës.	100%	M. Matraxhiu, A. Ramaj, M. Ucaj, SH. Muça dhe grupet e specialistëve.	U mentoruan 8 grupet e ngritura në 4 DRAP-et për procesin e paravlerësimit të 4 gjimnazeve dhe 4 shkollave 9-vjecare të përzgjedhura.
				1.1.6	Vlerësimi i plotë i shkollave në çdo DRAP.	Realizimi i gjithë etapave të vlerësimit në shkollë.	Vlerësimi i 4 fushave të udhëzuesit për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës.	100%	M. Matraxhiu, A. Ramaj, M. Ucaj, SH. Muça dhe grupet e specialistëve.	Grupet e DVC-së mentoruan 8 grupet e ngritura për procesin e vlerësimit të plotë të shkollës në 8 shkollat e përzgjedhura.
				1.1.7	Shkrimi i raportit bazuar tek gjetjet e dala nga vlerësimi i plotë i shkollës.	Sintetizimi i të dhënave për raportin e vlerësimit.	Raport vlerësimi bazuar tek gjetjet.	100%	M. Matraxhiu, A. Ramaj, M. Ucaj, Sh. Muça, R. Spahiu, A, Farkaj, U. Alku, Z. Kurti, A. Kacorri, M. Lika, K. Josifi, A. Ahmati.	U mentoruan 8 grupet e ngritura për hartimin e raportit të vlerësimit të plotë të shkollës.
				1.1.8	Hartimi i raportit të pilotimit.	Vlerësimi i efeketivitetit të treguesve/përshkruesve praktikë për vlerësimin e shkollës nga specialistët e DVC-së në bashkëpunim me grupet e inspektorëve, specialistëve, drejtorëve të shkollave gjatë procesit.	Raporti i pilotimit me gjetjet.	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça R. Spahiu A. Ahmati	U pilotuan treguesve, përshkruesit praktikë për vlerësimin e shkollës nga specialistët e DVC-së në bashkëpunim me grupet e inspektorëve, specialistëve, drejtorëve të shkollave gjatë procesit.

		1.2	Pilotimi i vlerësimit të brendshëm.	**1.2.1**	Realizimi i vlerësimit të brendshëm.	Realizimi i gjithë etapave të vlerësimit në shkollë. Përpunimi dhe sintetizimi i gjetjeve dhe rekomandimeve për raportin e vlerësimit të shkollës.	Raporti i vlerësimit të brendshëm.	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, SH. Muça	U organizuan tryeza të rrumbullakëta me drejtues të gjimnazeve dhe shkollave 9-vjecare të Tiranës.
				1.2.2	Përmirësimi i udhëzuesit pas pilotimit në terren.	Vlerësimi i efektivitetit të treguesve/përshkruesve praktikë për vlerësimin e brendshëm nga specialistët e DVC-së në bashkëpunim me grupet e specialistëve dhe drejtorëve të shkollave.	Hartimi i raportit të pilotimit të vlerësimit të brendshëm.	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, SH. Muça	U reflektuan përmirësimet në udhëzues pas pilotimit në terren.
		1.3	Hartimi i produkteve finale.	**1.3.1**	Rishikimi i 4 produkteve finale	Redaktimi shkencor dhe gjuhësor : a) Kornizën e vlerësimit të cilësisë së performancës së shkollës; b) Udhëzuesin e vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës; c) Metodologjinë për vlerësimin e jashtëm të shkollës; d) Metodologjia për vlerësimin e brendshëm.	Produktet finale	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça, I. Sina, Z. Kurti	U hartuan produktet finale për vlerësimin e cilësisë së shkollës, përkatësisht: a) Kornizën e vlerësimit të cilësisë së performancës së shkollës; b) Udhëzuesin e vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës; c) Metodologjinë për vlerësimin e jashtëm të shkollës; d) Metodologjia për vlerësimin e brendshëm.
2	Hartimi i produkteve për vlerësimin e IAP-ve	**2.1**	Hartimi i udhëzuesit për vlerësimin e jashtëm të kopshteve.	**2.1.1**	Analizë studimore për të përcaktuar strukturën e udhëzuesit.	Do të përcaktohen kriteret për të realizuar analizën krahasuese. Përcaktimi i metodologjisë së punës, konceptet kryesore numri i fushave, treguesve, niveleve, standardeve për hartimin e udhëzuesit.	Struktura e udhëzuesit.	100%	E. Veli, M. Ucaj	U krye analiza studimore për të përcaktuar strukturën e udhëzuesit.

				2.1.2	Ngritja e grupeve të punës për hartimin e fushave të udhëzuesit.	Ndarja e detyrave për secilin anëtar të grupit të punës.	Dorëzimi i drafteve për fushat.	100%	E. Veli	
				2.1.3	Hartimi i draftit	Hartimi i draft Kornizës për Vlerësimin e Cilësisë së Kopshtit	Dorëzimi i draft Kornizës	100%	E. Veli, M. Ucaj	U hartua draft Korniza
				2.1.4	Konsultimi i draft Kornizës	Konsultimi i draft Kornizës me Drejtorinë e Kurrikuës dhe palët e interesit	Rishikimi i produktit	100%	E. Veli, M. Ucaj	Në proces
		2.3	Vlerësimi i zbatimit të KPSH-së	**2.3.1**	Hartimi i metodologjisë së vlerësimit, për zbatimin e KPSH-së.	Diskutimi i metodologjisë për vlerësimin kombëtar të zbatimit të KPSH-së për periudhën 5-vjeçare.	Metodologji.	100%	T. Çobaj, E. Veli I. Sina, M. Ucaj Sh. Muça	U hartua metodologjia.
				2.3.2	Vlerësimi i aspekteve cilësore/ përgatitja e pyetësorëve.	Diskutimi i grupit të punës për vlerësimin e treguesve cilësorë nëpërmjet pyetësorëve.	Hartimi i pyetësorëve.	100%	T. Çobaj, Sh. Muça dhe grupet e specialistëve	U vlerësuan aspektet cilësore dhe u analizuan pyetësorët e zhvilluar me ZVAP=të dhe shkollat përkatëse të përzgjedhura.
				2.3.3.	Hartimi i raportit për vlerësimin kombëtar të zbatimit të KPSH-së për periudhën 5-vjeçare	Analizimi i të dhënave të dërguara online dhe rezultatet e pyetësorëve të zhvilluar.	Hartimi i raportit	100%	T. Çobaj, Sh. Muça, I. Sina dhe grupet e specialistëve	U hartua raporti për vlerësimin kombëtar të zbatimit të KPSH-së për periudhën 5-vjeçare.
		2.5	Hartimi i listë verifikimit për	**2.5.1**	Ngritja e grupeve të punës.	Përcaktimi i përgjegjësive të gjithë anëtarëve.	Analizimi i bazës ligjore.	100%	T. Çobaj, E. Veli	U ngritën grupet e punës për hartimin e listë verifikimit për zbatimin e rregullores së IAP-ve..

			"Rregulloren e funksionimit të IAP-ve në Republikën e Shqipërisë"	**2.5.3**	Hartimi i draftit të parë të listës së verifikimit.	Hartohet drafti i listës së verifikimit për të gjithë rregullohen.	Draft lista.	100%	M. Matraxhiu, A. Ramaj R. Spahiu, A. Farkaj, U. Alku, Z. Kurti, A. Kacorri, M. Lika, K. Josifi, A.Ahmati	U hartua draft listë verifikimi i rregullores së IAP-ve.
				2.5.4	Konsultimi i draft listës brenda DVC-së.	Të gjithë produktet e anëtarëve konsultohen brenda DVC-së.	Përmirësimi i draftit.	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, dhe grupet e specialistëve	U konsultua draft rregullorja brenda DVC-së
				2.5.5	Rishikimi i listë verifikimit për Rregulloren e IAP-ve.	Redaktimi shkencor dhe gjuhësor i rregullores nga grupi qendror.	Përmirësimi draftit	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, Z. Kurti	U realizua redaktimi gjuhësor dhe shkencor i rregullores.
				2.5.6	Dorëzimi i produktit në Inspektoratin Qendror.	Përshtatja e formatit të rregullores në përputhje me sistemin "e-inspektimi"	Produkti final	100%	M. Ucaj	U përshtaten formatet e rregullores në përputhje me sistemin "e-inspektimi" dhe u dorëzua pranë inspektoratit qendror.
		2.6	Hartimi i listave të verifikimit për sistemin "e-inspektimi" .	**2.6.1**	Ngritja e grupeve të punës.	Përcaktimi i përgjegjësive të gjithë anëtarëve.	Analizimi i bazës ligjore.	100%	T. Çobaj, E. Veli I. Sina	U hartua draft listë verifikimi
				2.6.2	Hartimi i listave të verifikimit	**1.** Ligji 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në R. Sh.", i ndryshuar.	Draft lista	100%	M. Lika	U hartua draft listë verifikimi
						2. Udhëzimi nr. 8, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve".	Draft lista	100%	Z. Kurti	U hartua draft listë verifikimi

			(*Jashtë planifikimit*)			**3.** VKM nr. 600, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 IAP dhe të kritereve për oficerët e sigurisë”.	Draft lista	100%	K. Josifi	U hartua draft listë verifikimi
						4. Udhëzimi nr. 25, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve", i ndryshuar.	Draft lista	100%	U. Alku	U hartua draft listë verifikimi
						5. Udhëzimi nr. 12, “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë dhe nxënësve në IAP, përmbajtjen e dosjeve të tyre personale, si dhe për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave kontaktuese të prindërve/kujdestarëve ligjorë të nxënësve”.	Draft lista	100%	A. Ahmati	U hartua draft listë verifikimi
						6. Udhëzimi nr. 26, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.	Draft lista	100%	A. Ahmati	U hartua draft listë verifikimi
						7. Udhëzimin nr. 17, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimimin me	Draft lista	100%	M. Ucaj Sh. Muca	U hartua draft listë verifikimi

						kohë të pjesshme në arsimin bazë”				
						8. Udhëzimi nr. 13, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”	Draft lista	100%	R. Spahiu	U hartua draft listë verifikimi
						9. Udhëzimi nr. 30, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.	Draft lista	100%	R. Spahiu	U hartua draft listë verifikimi
						10. Udhëzimi nr. 25, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”.	Draft lista	100%	Z. Kurti	U hartua draft listë verifikimi
						11. Udhëzimi nr. 2, “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.	Draft lista	100%	Z. Kurti	U hartua draft listë verifikimi
						12. Udhëzimi nr. 44, “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar.	Draft lista	100%	A. Farkaj	U hartua draft listë verifikimi

						13. Udhëzimi nr. 34, datë 16.11.2018, "Për ndalimin e telefonit celular në IAP".	Draft lista	100%	A. Farkaj	U hartua draft listë verifikimi
						14. Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 "Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë".	Draft lista	100%	A. Farkaj	U hartua draft listë verifikimi
						15. Urdhri nr. 313, datë 20.10.2020, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në IAP dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social"	Draft lista	100%	A. Farkaj	U hartua draft listë verifikimi
				2.6.3	Rishikimi i 15 listave të verifikimit.	Redaktimi shkencor dhe gjuhësor i 13 listave të verifikimit nga grupi qendror.	Përmirësimi i draftit	100%	T. Çobaj, M. Ucaj, Z. Kurti	U realizua redaktimi gjuhësor dhe shkencor i 13 listë verifikimeve.
				2.6.4	Dorëzimi i produkteve në Inspektoratin Qendror.	Përshtatja e formatit të 15 listave të verifikimit në përputhje me sistemin "e-inspektimi"	Produktet finale	100%	M. Ucaj	U përshtaten formatet e 15 listë verifikimeve në përputhje me sistemin "e-inspektimi" dhe u dorëzuan pranë inspektoratit qendror.
3.	**Rishikimi i platformave për vlerësimin e shkollës (Jashtë planifikimit)**	**3.1**	Përditësimi i 23 platformave me rregulloren e IAP-ve dhe Udhëzuesin për	**3.1.1**	Ngritja e grupeve të punës	Ndarja e grupeve të punës	Ndarja e grupeve	100%	T. Çobaj, E. Veli,	U ngritën grupet e punës për hartimin e platformave
				3.1.2	Rishikimi i platformave	**1.** Përzgjedhja/shpërndarja/shitja e teksteve shkollore	Draft platforma	100%	E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça	U hartua draft platforma
						2. Plani afatmesëm dhe plani vjetor i shkollës.	Draft platforma	100%	E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça	U hartua draft platforma

			vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës, ASCAP 2020.			**3.** Planet vjetore lëndore/ të periudhave	Draft platforma	100%	E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça	U hartua draft platforma
						4. Rregullorja e brendshme e shkollës	Draft platforma	100%	E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça	U hartua draft platforma
						5. Regjistrimet, ndarja e klasave, norma mësimore	Draft platforma	100%	E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça	U hartua draft platforma
						6. Zbatimi i nismës "3 lëndë në 6 orë"	Draft platforma	100%	E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça	U hartua draft platforma
						7. Vlerësimi i plotë i shkollës	Draft platforma	100%	E. Veli, M. Ucaj	U hartua draft platforma
						8. Vlerësimi i arritjeve nga drejtuesit	Draft platforma	100%	E. Veli, M. Ucaj	U hartua draft platforma
						9. Psikologu/punonjësi social dhe oficeri i sigurisë	Draft platforma	100%	E. Veli, M. Ucaj	U hartua draft platforma
						10. Ngritja dhe funksionim i organizmave të shkollës	Draft platforma	100%	R. Spahiu, A. Kacori	U hartua draft platforma
						11. Mospërdorimi i celularëve.	Draft platforma	100%	R. Spahiu, A. Kacori	U hartua draft platforma
						12. Nisma e ministrit "Bëj detyrat e shtëpisë"	Draft platforma	100%	R. Spahiu, U. Alku	U hartua draft platforma
						13. Vlerësimi i nxënësve	Draft platforma	100%	R. Spahiu, Z. Kurti	U hartua draft platforma
						14. Karta e Performancës së Shkollës.	Draft platforma	100%	M. Matraxhiu, Z. Kurti, A. Ahmati	U hartua draft platforma
						15. Vetëvlerësimi i shkollës	Draft platforma	100%	M. Matraxhiu, Z. Kurti, A. Ahmati	U hartua draft platforma

						16. Arritjet e nxënësve në provimet kombëtare	Draft platforma	100%	A. Rama, M. Matraxhiu	U hartua draft platforma
						17. Veprimtaritë plotësuese (kalendari i veprimtarive)	Draft platforma	100%	A. Kacori, Z. Kurti	U hartua draft platforma
						18. Mjediset fizike të shkollës	Draft platforma	100%	A. Ahmati, A. Farka	U hartua draft platforma
						19. Mësuesi ndihmës në nivel ZVAP	Draft platforma	100%	A. Kacori, A. Ahmati	U hartua draft platforma
						20. Mësuesi ndihmës në nivel shkolle	Draft platforma	100%	A. Kacori, A. Ahmati	U hartua draft platforma
						21. Dokumentacioni shkollor (amza, regjistra)	Draft platforma	100%	M. Lika, K. Josifi	U hartua draft platforma
						22. Shkollat qendër komunitare në nivel ZVAP	Draft platforma	100%	U. Alku, A. Farka	U hartua draft platforma
						23. Shkollat qendër komunitare në nivel shkolle	Draft platforma	100%	U. Alku, A. Farka	U hartua draft platforma
						24. Mirëqenia e nxënësve dhe krijimi i mjedisit të sigurt në shkollë dhe përreth saj	Draft platforma	100%	M. Ucaj	U hartua platforma
						25. Hartimi i 2 pyetësorëve (prindër dhe nxënës) për evidentimin e dhunës në shkollë	Draft pyetësorët	100%	M. Ucaj	U hartuan 2 pyetësorët
						26. Planet mësimore (sipas temave mësimore të miratuara nga MASR);	Draft platforma	100%	A. Ramaj, M. Lika, K. Josifi, A. Farka	U hartua draft platforma
						27. Masat e marra për zhvillimin e mësimit në mjediset fizike të shkollës;	Draft platforma	100%	R. Spahiu, Sh. Muça, A. Ahmati,	U hartua draft platforma

									U. Alku	
						28. Masat e marra për zhvillimin e mësimit në mënyrë të kombinuar;	Draft platforma	100%	R. Spahiu, Sh. Muça, A. Ahmati, U. Alku	U hartua draft platforma
						29. Masat e marra për zhvillimin e mësimit vetëm në distancë;	Draft platforma	100%	R. Spahiu, Sh. Muça, A. Ahmati, U. Alku	U hartua draft platforma
						30. Ngritja dhe funksionimi i rrjetit profesional të mësuesve ndihmës;	Draft platforma	100%	A. Ahmati, R. Spahiu, Z. Kurti, U. Alku, A. Farka	U hartua draft platforma
						31. Ngritja dhe funksionimi i rrjeteve profesionale të mësuesve.	Draft platforma	100%	M. Lika, M. Matraxhiu, A. Ramaj, K. Josifi, A. Kacorri	U hartua draft platforma
				3.1.2	Rishikimi i platformave nga grupi qendror	Redaktimi shkencor dhe gjuhësor.	Platformat finale	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj.	U krye redaktimi shkencor dhe gjuhësor i 30 platformave dhe u dorëzuan pranë DPAP-së
4.	Vlerësimi i kurrikulës së shkencave dhe TIK	**4.1**	Vlerësim i cilësisë së zbatimit të kurrikulës në fushën shkencës.	**4.1.1**	Ngritja e grupit të punës dhe hartimi i metodologjisë së vlerësimit.	Diskutimi i metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së kurrikulës së zbatuar në lëndët fizikë, kimi, biologji.	Hartimi i platformës së vlerësimit	6-mujore	T. Çobaj, R. Spahiu, U. Alku, A. Kacori	Objektivi nuk është realizuar për shkak të pandemisë
				4.1.2	Vlerësimi i treguesve cilësorë.	Diskutimi i grupit të punës për vlerësimin e treguesve cilësorë nëpërmjet pyetësorëve (referuar "Udhëzuesit për vlerësimin e	Hartimi i pyetësorëve për vlerësimin	6-mujore	R. Spahiu, U. Alku, A. Kacori	

						jashtëm dhe të brendshëm të shkollës”).	e treguesve cilësorë.			
				4.1.3	Hartimi i fishave të vëzhgimit.	Hartimi i fishave të vëzhgimit për vëzhgimin e orëve mësimore të mësuesve të IT-së, mbështetur në treguesit e fushave të “Udhëzuesit për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës”.	Hartohen fishat përkatëse.	6-mujore	R. Spahiu, U. Alku, A. Kacori	
				4.1.4	Realizimi i vlerësimit. Hartimi i raportit.	Vlerësimi realizohet në 4 DRAP-e mbështetur në metodologjinë e vlerësimit.	Raportet e vlerësimit në nivel DRAP-i.	6-mujore	R. Spahiu, U. Alku, A. Kacori	
				4.1.5	Hartimi i raportit.	Përmblidhen gjetjet e raporteve në nivel DRAP-i në raportin e vlerësimit në nivel kombëtar për cilësinë e zbatimit të kurrikulës në fushën e shkencave.	Hartimi i raportit në nivel kombëtar.	6-mujore	R. Spahiu, U. Alku, A. Kacori	
		4.2	Vlerësim i cilësisë së zbatimit të kurrikulës së TIK-ut	**4.2.1**	Hartimi i metodologjisë së vlerësimit .	Diskutimi i metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së zbatimit të TIK-ut.	Hartimi i platformës së vlerësimit.	Vjetore	I. Sina, K. Josifi	
				4.2.2	Vlerësimi i treguesve cilësorë.	Diskutimi i grupit të punës për vlerësimin e treguesve cilësorë nëpërmjet pyetësorëve (referuar “Udhëzuesit për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës”).	Hartimi i pyetësorëve për vlerësimin e treguesve cilësorë.	Vjetore	I. Sina, K. Josifi	
5.	**Vlerësimi i mësimit online** (Objektiv shtesë si pasojë e	**5.1**	Vlerësimi i cilësisë së video-ve dhe PPT-ve për	**5.1.1**	Vlerësimi i video-ve dhe PPT-ve për lëndët matematikë, gjuhë shqipe	Vlerësimi i videove dhe PPT-ve për çdo orë mësimore të realizuar për transmetimin në TVSH, gjykimi i tyre dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim.	Analiza vlerësuese.	100%	E. Veli, Sh. Muça, I. Sina	U krye vlerësimi i cilësisë së video-ve dhe PPT-ve për mësimin online matematikë, gjuhë shqipe dhe dituri natyre, në klasat

	situatës së krijuar nga COVID)		mësimin online.		dhe dituri natyre, në klasat e AF.					e AF, si dhe TIK për klasat VI-XII.
6.	**Hartimi i planeve mësimore** (Objektiv shtesë si pasojë e situatës së krijuar nga COVID)	**6.1**	Hartimi i planeve mësimore	**6.1.1**	Hartimi i planeve mësimore të lëndëve gjuhë shqipe kl. V dhe Dituri natyre dhe aftësim teknologjik	Përcaktimi i temave mësimore bazuar në programin lëndor dhe hartimi i planeve mësimore të lëndëve gjuhë shqipe kl. V dhe Dituri natyre dhe aftësim teknologjik	Planet mësimore	100%	E. Veli, Sh. Muça, I. Sina	U hartuan planet mësimore të lëndëve gjuhë shqipe kl. V dhe Dituri natyre dhe aftësim teknologjik
7.	**Monitorime me urdhër të MASR**	**7.1**	Monitorimi i provimeve të Maturës Shtetërore	**7.1.1**	Monitorimi i provimeve të gjuhës së huaj, gjuhës shqipe dhe letërsisë, matematikës dhe provimet me zgjedhje.	U shoqëruan materialet e provimeve dhe monitoruan mjediset e zhvillimit të provimeve nga secili specialist mbështetur në urdhrat individualë.	Raporte monitorimi	100%	DVC	U krye monitorimi i mjediseve të provimit dhe u dërguan raportet përkatëse të monitorimit në MASR.
8.	**Hartimi i standardeve profesionale të inspektorëve të shkollave** *(Jashtë planifikimit)*	**8.1**	Hartimi i standardeve profesionale të inspektorëve të shkollave	**8.1.1**	Studimi i përvojave kombëtare dhe ndërkombëtare	Analizë krahasuese mbi standardet e inspektorit. Përcaktimi i standardeve dhe kompetencave		100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj Sh. Muca A. Kacori	U hartuan 5 draft fushat e Standardeve
				8.1.2	Konsultimi i draft Standardeve	Konsultimi i draft standardeve me Shkollën e drejtorëve, konsulencën e huaj dhe DRAP-et.		100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj Sh. Muca A. Kacori	U krye konsultimi

				8.1.3	Standardet finale	Reflektimi i komenteve mbi draft standardet dhe hartimi i produktit final.	Produkti final	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj Sh. Muca A. Kacori	Produkti u dorëzua në MASR për miratim
9.	**Ngritja e kapaciteteve të drejtorëve të shkollave**	**9.1**	Trajnimi i drejtorëve për paketën e vlerësimit të cilësisë së shkollës	**9.1.1**	Hartimi i moduleve të trajnimit	Hartimi i katër moduleve për trajnimin e drejtorëve të shkollave	Katër modulet e trajnimit	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj	U hartuan modulet
				9.1.2	Hartimi i metodologjisë së trajnimit	Hartimi i metodologjisë bazuar në modulet e trajnimit. Ndarja e grupeve të punës	Metodologjia e trajnimit	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj	U hartua metodologjia
				9.1.3	Trajnimi i drejtorëve	Trajnimi i drejtorëve për paketën e cilësisë së shkollës.	Trajnimi i drejtorëve drejtpërdrejtë ose online	100%	Specialistët e DVC-së	U trajnuan rreth 1000 drejtorë shkollash
10.	**Hartimi i Manualit të riskut**	**10.1**	Hartimi i Manualit për inspektimin /vlerësimin e shkollës me bazë risku	**10.1.1**	Analizë studimore për strukturën e manualit	Përcaktimi i kritereve për të realizuar analizën krahasuese. Përcaktimi i metodologjisë së punës, konceptet kryesore.	Struktura e udhëzuesit.	100%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj Sh. Muca	U krye analiza studimore për të përcaktuar strukturën e manualit.
				10.1.2	Hartimi i draft Manualit	Hartimi i draft manualit, përcaktimi i faktorëve të riskut.	Draft manuali	50%	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj Sh. Muca	Në proces

Përgatiti raportin

Gerti Janaqi

Dorina Rapti

Bashkim Muça

Teuta Çobaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ASCAP

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

RAPORTI JANAR – DHJETOR 2021

DHJETOR, 2021

PËRMBAJTJA

I. AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ASCAP) 4

1.1. Misioni ASCAP 4

1.2. Objektivat e përgjithshëm ASCAP, 2021 5

1.3. Sfidat e ASCAP-it 6

II. DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT 6

2.1. Gjendja aktuale 6

2.1.1 Kurrikula 6

2.1.2 Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë 7

2.2. Vizioni i DKK 7

2.3. Misioni i DKK 7

2.4. Vlerat drejtuese të DKK 7

2.5. Detyrat kryesore të DKK 7

2.6. Objektivat e përgjithshëm të DKK 9

2.7. Objektivat e detajuar të DKK 9

2.8. Plani dhe realizimi i veprimtarive për DREJTORINË E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT 11

III. DREJTORIA E PERFORMANCËS 28

3.1. Vizioni 28

3.2. Qëllimi 28

3.3. Vlerësimi i sistemit 28

Vlerësimet nga programet/politikat specifike 30
3.5. Objektivat e përgjithshëm të Drejtorisë së Performancës 31
4.1. Tabela e veprimtarive të zhvilluara nga DP në periudhën 01 janar - 31 dhjetor 2022 34
IV. DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË 42
4.1 Gjendja aktuale 42
4.1.1 Vlerësimi i cilësisë së kurrikulës 43
4.1.2 Organizimi dhe drejtimi i institucioneve arsimore 43
4.2 Vizioni 43
4.3 Misioni 44
4.4 Vlerat drejtuese 44
4.5 Detyrat kryesore të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë 44
4.6 Objektivat e përgjithshëm për periudhën janar-dhjetor 2021 45
4.7 Objektivat e detajuar për periudhën qershor-dhjetor 2021 46
4.8 Tabela e veprimtarive të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë 46

I. AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ASCAP)

1.1.Misioni ASCAP

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 27.02.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). Misioni i ASCAP është të garantojë performancën e sistemit të arsimit parauniversitar dhe cilësinë e arsimimit parauniversitar publik e privat në përputhje me qasjen e kurrikulës së bazuar në zhvillimin e kompetencave.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) vlerëson performancën e sistemit arsimor parauniversitar, efektshmërinë dhe eficencën e masave si dhe përmbushjen e objektivave;
b) vlerëson mënyrën e organizimit e të funksionimit të sistemit arsimor parauniversitar dhe merr masat e nevojshme në rast mbivendosjeje funksionesh apo mungese ekzekutimi të detyrave funksionale nga institucionet përgjegjëse;
c) vlerëson si ndërlidhen, koordinohen apo ndërveprojnë institucionet e sistemit arsimor parauniversitar me njëri-tjetrin, duke garantuar nivelin e duhur të integrimit për sigurimin e arsimit parauniversitar cilësor;
d) kryen analiza të ndryshme mbi bazën qendrore e të integruar të të dhënave të sistemit të arsimit parauniveritar dhe shpërndan informacionin;
e) harton dhe i propozon ministrit për miratim standarde, protokolle, rregulla për ofrimin e shërbimeve arsimore si dhe vlerëson impaktin e tyre në këto shërbime;
f) analizon, zhvillon e rishikon dokumentet si: korniza kurrikulare, programet lëndore dhe standardet, sipas fushave kurrikulare;
g) harton dhe boton dokumentet kurrikulare për arsimin parauniversitar si dhe materiale mbështetëse për zbatimin e kurrikulës, në nivel kombëtar;
h) harton, analizon dhe rishikon standardet e zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare;
i) vlerëson nevojat për zhvillim profesional, programet kombëtare dhe materialet mbështetëse për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
j) organizon zhvillimin profesional dhe menaxhon procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit parauniversitar, publik dhe privat;

k) realizon punë kërkimore-studimore, analiza periodike dhe u ofron ekspertizë strukturave politike e vendimmarrëse për politikat arsimore dhe reformat në fushën e arsimit parauniversitar;

l) ofron këshillim për institucionet arsimore parauniversitare të të gjitha niveleve në fushat e përmbajtjes kurrikulare, të didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe në drejtimin e menaxhimit të shkollës dhe arsimit në tërësi;

m) vlerëson, mbi bazë risku, veprimtarinë e institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar dhe të institucioneve arsimore publike e private të sistemit të arsimit parauniversitar, për respektimin në vazhdimësi të kushteve dhe detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor, shoqëruar me lënien e detyrave/sugjerimeve/rekomandimeve për përmirësimin e elementeve të caktuara të institucioneve apo gjithë sistemit të arsimit parauniversitar, si: kurrikul, standarde dhe metodologji;

n) nënshkruan marrëveshje dhe bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë, institucione të tjera apo me organizata kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për veprimtari apo aktivitete që lidhen me misionin e saj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

1.2.Objektivat e përgjithshëm ASCAP, 2021

Gjatë vitit 2021, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ka këto objektiva të përgjithshme:

1. Kurrikul me standarde europiane dhe më gjerë për zhvillimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës.
2. Zhvillimi profesional i drejtuesve dhe mësuesve për të përmirësuar cilësinë e procesit të mësimdhënie-nxënies (formimi fillestar dhe i vazhduar).
3. Nxitja e arsimit cilësor dhe përmirësimi i gjithëpërfshirjes në edukim.
4. Krijimi i kornizës së treguesve dhe mbledhja e të dhënave në funksion të vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar, publik dhe privat.
5. Garantimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar publik dhe privat.
6. Hartim i Kornizës për Vlerësimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare.
7. Hartimi i treguesve për vlerësimin e cilësisë së organizimit dhe drejtimit të Institucioneve Arsimore Parauniversitare.

1.3.Sfidat e ASCAP-it

Për të realizuar objektivat, ASCAP përballet me këto sfida:

- Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë për arsimim duhet të bazohet në kompetencat e të nxënit gjatë gjithë jetës.
- Bashkëpunimi me fakultetet e mësuesisë dhe partnerë të tjerë lokalë dhe ndërkombëtarë për rishikimin e kurrikulës së formimit fillestar të mësuesve në përputhje me kurrikulën e zbatuar në arsimin parauniversitar.
- Komunikimi i vazhdueshëm me institucione në varësi të MAS për mbledhjen e raporteve dhe materialeve që lidhen me vlerësimin e performancës së sistemit të arsimit parauniversitar.
- Zhvillimi profesional i stafeve të DRAP/ZVAP për inspektimin dhe monitorimin e institucioneve arsimore me qëllim përmirësimin e sistemit të APU.

II. DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT

2.1.Gjendja aktuale

2.1.1 Kurrikula

Kurrikula e reformuar u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve, pavarësisht nga prejardhja ose veçoritë e tyre. Ajo u krijon mundësi të barabarta për sukses secilit nxënës. Kurrikula e re ofron zgjidhje që mbajnë parasysh nevojat vetjake dhe stilet e të nxënit, si dhe përvojat mësimore paraprake të nxënësve, si kusht për përmirësimin e nivelit të arritjeve të tyre. Ajo hartohet dhe zbatohet në harmoni me veçoritë kryesore të grup-moshave dhe në varësi të mundësive dhe të gatishmërisë së fëmijëve për të nxënë. Në të njëjtën kohë, kurrikula i qartëson nxënësit dhe prindërit e tyre për drejtimin, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënit në shkallë dhe nivele të ndryshme arsimore, të cilat janë bazë për nivelet dhe shkallët pasardhëse. Mësimdhënia dhe nxënia në kurrikulën e reformuar bëhet nëpërmjet situatave kontekstuale të të nxënit, të cilat mbështesin dhe ndihmojnë zhvillimin e kompetencave.

2.1.2 Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë

Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë, konsiderohet si një prioritet i arsimit për të përmirësuar dhe rritur kompetencat profesionale të mësuesit në përshtatje me reformat arsimore, si dhe rritjen e cilësisë së individit për t'u përsosur profesionalisht. Prioritet kryesor është tërheqja dhe mbajtja në punë e mësuesve cilësorë duke i motivuar ata me skema trajnimi dhe kualifikimi, të cilat bazohen në rezultate dhe jo thjesht në vitet e punës.

2.2.Vizioni i DKK

Vizioni i DKK është të hartojë kurrikul që zhvillon te nxënësit kompetencat e të nxënit gjatë gjithë jetës si dhe të fuqizojë zhvillimin profesional të mësuesve për zbatimin e kurrikulës, duke mbështetur, inkurajuar dhe motivuar mësuesit për të rritur standardet profesionale, për të krijuar një klimë që lehtëson mësimdhënien – nxënien dhe duke i bërë nxënësit të jenë efektiv e të suksesshëm në të nxënë.

2.3.Misioni i DKK

Misioni i DKK është që nëpërmjet punës kërkimore dhe hartimit në fushën e kurrikulës si dhe zhvillimit profesional të mësuesve të përmirësojë punën e mësuesve dhe stafeve drejtuese përmes përvojave të përshtatshme të mësimdhënie dhe nxënies, mbështetjes profesionale, gjithëpërfshirjes, kujdesit, frymëzimit, të cilat prevalojnë direkt në zhvillimin e kompetencave lëndore dhe kompetencave kyçe.

2.4.Vlerat drejtuese të DKK

DKK udhëhiqet nga këto vlera drejtuese:

- Ndërmerr iniciativa dhe propozon përmirësime në politikat e fushës së kurrikulës dhe sistemit të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë, të cilat ndikojnë drejt për drejt në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në shkollë.
- Mbështet dhe zhvillon profesionalisht stafet e njësive arsimore vendore dhe të institucioneve arsimore në zbatimin e politikave dhe standardeve bashkëkohore për përmirësimin e cilësisë në shkollë.
- Mësuesit janë bartësit kryesorë të të gjitha ndryshimeve dhe gjithçka varet nga formimi dhe motivimi i tyre.

2.5.Detyrat kryesore të DKK

Detyrat kryesore të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Kualifikimit, në ASCAP janë:

- analizon, zhvillon dhe rishikon dokumentet e rëndësishme si: korniza kurrikulare, programet lëndore, standardet sipas fushave/lëndëve kurrikulare;
- harton dhe boton dokumentet kurrikulare për arsimin parauniversitar;
- harton programe lëndore për të gjitha ciklet (arsimi parashkollor dhe të gjitha klasat 1-12);
- harton dhe boton udhëzues kurrikularë si dhe materiale mbështetëse për zbatimin e kurrikulës në nivel kombëtar;
- harton, analizon dhe rishikon standardet e zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare;
- vlerëson nevojat për zhvillim profesional, programet kombëtare dhe materialet mbështetëse për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
- harton programe kombëtare orientuese për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar;
- organizon zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit parauniversitar;
- menaxhon dhe organizon procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit parauniversitar;
- mbështet funksionimin e rrjeteve profesionale dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm të drejtuesve të këtyre rrjeteve nëpërmjet instrumenteve përkatëse;
- menaxhon procesin e akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
- harton instrumente për vlerësimin e cilësisë së trajnimeve të ofruara nga agjencitë që kanë akredituar programe/module trajnimi për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
- harton fondin e pyetjeve për testimin kombëtar “Mësues për Shqipërinë” si domosdoshmëri për sigurimin e cilësisë së formimit të mësuesve kandidatë për ushtrimin e profesionit të mësuesit në arsimin parauniverstar;
- realizon punë kërkimore-studimore, analiza periodike dhe u ofron ekspertizë strukturave politike e vendimmarrëse për politikat arsimore dhe reformat në fushën e arsimit parauniversitar;
- ofron këshillim për institucionet arsimore parauniversitare të të gjitha niveleve, në fushat e përmbajtjes kurrikulare, didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe për drejtimin dhe menaxhimin e shkollës dhe arsimit në tërësi;

- bashkërendon veprimtarinë e saj me drejtoritë dhe sektorët e tjerë të ASCAP-it, me ministrinë përgjegjëse për arsimin, si dhe me institucione të tjera të të gjitha niveleve brenda dhe jashtë vendit, për realizimin cilësor të detyrave të saj;
- mundëson dhe mbështet kualifikimin dhe vetëkualifikimin e stafit të drejtorisë;
- bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë apo me organizata kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për veprimtari apo aktivitete që lidhen me detyrat e saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2.6.Objektivat e përgjithshëm të DKK

DKK ka këto objektiva të përgjithshme për janar - dhjetor 2021:

- Të hartojë dhe të rishikojë kurrikulën me standarde europiane dhe më gjerë për zhvillimin e komptencave të të nxënit gjatë gjithë jetës.
- Të organizojë zhvillimin profesional të drejtuesve dhe mësuesve për të përmirësuar cilësinë e procesit të mësimdhënie-nxënies.
- Të nxisë arsimin cilësor dhe përmirësimin e gjithëpërfshirjes në edukim.

2.7.Objektivat e detajuar të DKK

DKK ka këto objektiva të detajuara për vitin 2021:

1) Të hartojë materiale ndihmëse për mësuesit nga mësuesit. Përvoja nga praktika e mësuesve me temë "Hartimi i llojeve të pyetjeve bazuar në kompetenca ".
2) Të plotësojë paketën kurrikulare të arsimit parashkollor.
3) Të rishikohet udhëzuesi për Arsimin Fillor lidhur me zbatimin e kurrikulës me kompetenca.
4) Të zbatojë platformën "Një ditë në shkollë" për analizën e vlerësimit të kurrikulës së zbatuar në AML. (I mbartur nga viti 2020 për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19).
5) Të hartojë planin e veprimit për aftësitë digjitale në arsim bazuar në dokumentin “Action Plan for digjital Education 2021 – 2027” të Komisionit Europian.

6) Të kryejë studimin mbi vlerësimin e nxënësit bazuar në kompetenca në AMU.
7) Të hartojë materiale tutoriale për përdorimin e platformave *zoom, google forms, gjeogebra, desmos, mathtyp etj.*
8) Të hartojë programet orientuese të maturës shtetërore për vitin shkollor 2021-2022.
9) Të realizohet redaktimi shkencor dhe sigurimi i cilësisë së videove që do të publikohen në Radio Televizionin Shqiptar – Shkolla si dhe në platformën akademi.al..
10) Të hartojë modulet e trajnimit për mësuesit që japin mësim në klasat e 12-ta për lëndët gjuhë shqipe, letërsi dhe matematikë për vlerësimin formues të nxënësit në koherencë me provimet e maturës shtetërore.
11) Të hartohen dhe përshtaten modulet e trajnimit për mësuesit e shkollave pilot për zbatimin e kurrikulës për median dhe informimin duke përfshirë edhe situatën e krijuar nga pandemia COVID 19 si një nga çështjet që sundon në mediat e sotme.
12) Të organizojë procesin e kualifikimit të mësuesve 2021.
13) Të koordinojë punën e KAPT.
14) Të mbështesë testimin e informatizuar "Mësues për Shqipërinë" nëpërmjet pjesëmarrjes në komisionet e provimeve.
15) Të zhvillojë kapacitetet e drejtuesve të rrjeteve profesionale në arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm lidhur me udhëzuesit, raportet, udhëzimet për zbatimin e kurrikulës dhe zhvillimin profesional të mësuesve si dhe për përdorimin e platformave online në procesin mësimor.
16) Të hartojë raportin e identifikimit të nevojave të mësuesve.
17) Të trajnohen mësuesit e klasave 12-ta për lëndët gjuhë shqipe, letërsi dhe matematikë për vlerësimin formues të nxënësit në koherencë me provimet e maturës shtetërore.
18) Të koordinojë dhe të organizojë procesin e regjistrimit të mësuesve të gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë.
19) Të zhvillojë kapacitetet e ZVAP-ve dhe DRAP-eve lidhur me raportin e identifikimit të nevojave të mësuesve, udhëzimet e reja për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e mësuesve.
20) Të ngrihen kapacitetet e mësuesve ndihmës për mbështetje e nxënësve me nevoja të veçanta.

21) Të ngrihen kapacitetet e punonjësve të shërbimit psiko-social dhe oficerëve të sigurisë lidhur me veçoritë e moshës.

22) Të organizojë seminarin e përvitshëm mbi programin e integruar të mësimit shqip në diasporë.

23) Të bashkëpunojë me institucionet qendrore, njësitë arsimore vendore, me specialistë të sigurimit të cilësisë dhe me partnerë të tjerë lokalë dhe ndërkombëtarë, për zbatimin e dokumenteve kurrikularë me kompetenca si dhe për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë, për ta zhvilluar shkollën gjithnjë e më shumë në një shkollë në shërbim të komunitetit.

2.8. Plani dhe realizimi i veprimtarive për DREJTORINË E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT

Nr.	Objektiva	Nr.	Tregues	Përshkrimi i treguesit	Produkt	Frekuenca dhe mënyra e matjes	Realizimi vjetor
Objektivi i përgjithshëm 1: Kurrikul me standarde europiane dhe më gjerë për zhvillimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës							
1.1	Të hartojë materiale ndihmëse për mësuesit nga mësuesit - Përvoja nga	1.1.1	Mbledhja e materialeve nga grupet e punës së mësuesve dhe përzgjedhja e teksteve që do të përfshihen në manual.	Materiali i përvojave nga praktika e mësuesve do të përmbajë modele pyetjesh bazuar në vlerësimin e kompetencave të hartuara nga vetë mësuesit.	Materialet nga mësuesit	6-mujore	100% Janë hartuar 12 udhëzues sipas profileve lëndore për llojet e pyetjeve bazuar në kompetenca. Udhëzuesit janë publikuar në faqen zyrtare të ASCAP dhe janë

	praktika e mësuesve me temë "Hartimi i llojeve të pyetjeve bazuar në kompetenca”	1.1.2	Përgatitja e materialit. (I mbartur nga viti 2020 për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19).	12 materiale të përgatitur dhe publikuar më faqen zyrtare të ASCAP.	12 grupe pune mësuesish sipas profileve lëndore.	Vjetore	dërguar në ZVA-të dhe DRAP-et për t’u përcjellë me mësuesit. Udhëzuesit janë: Biologji, Fizikë, Gjeografi, Gjuhë angleze, Gjuhë Frënge, Gjuhë Gjermane, Gjuhë Italiane, Gjuhë Shqipe, Letërsi, Histori, Kimi, Matematikë.
1.2	Të plotësojë paketën kurrikulare të arsimit parashkollor	1.2.1	Diskutimi i dokumentit të standardeve të drejtorit të arsimit parashkollor.	-Tryeza të rrumbullakëta ose takime online, në varësi të situatës me specialistët e DRAP, ZVA, Bashki, Drejtuese kopshtesh) -Miratimi nga MAS i standardeve të drejtorit të arsimit parashkollor.	Dokumenti i standardeve të drejtorit të kopshtit.	Gjashtë mujori i parë	100% Ka përfunduar materiali i Standardeve për drejtuesit e arsimit parashkollor. Janë zhvilluar takime online me drejtues rrjeti, specialist bashkish të DRAP LEZHË, DRAP KORCË, DRAP DURRËS, DRAP FIER. Janë hartuar 2 module trajnimi për mësuesit e klasave pilot. Ka përfunduar plani dhe programi i gjuhës angleze për klasën e parë
		1.2.2	- Trajnimi dhe mentorimi i mësuesve që pilotojnë programin e gjuhës angleze në klasat përgatitore pilot;	Ndjekja e pilotimit të programit të gjuhës angleze në klasat përgatitore.	-Modulet e trajnimit - Raporti i pilotimit të programit të gjuhës	9 - mujore (në varësi të vendim	

			- Hartimi i moduleve për trajnimin e mësuesve të klasave pilot; - Hartimi i raportit për MAS për ecurinë e pilotimit të programit të gjuhës angleze; - Plani dhe programi i gjuhës angleze për klasën e parë.		angleze në klasat përgatitore.	it që do të marrë MAS, mund të jetë edhe vjetore)	si dhe është hartuar moduli i trajnimit. Është bërë dhe raporti final. Deri në dhjetor 2021 janë trajnuar 214 mësues të gjuhës angleze që zbatojnë programin e klasës së parë. Trajnimet do të vijojnë edhe gjatë vitit 2022.
1.3	Të rishikohet udhëzuesi për Arsimin Fillor lidhur me zbatimin e kurrikulës me kompetenca.	1.3.1	Të rishikohet udhëzuesi i arsimit fillor.	Të rishikohet udhëzuesi i arsimit fillor nga grupet e punës së mësuesve për zbatimin sa më efektiv të kurrikulës me kompetenca.	Udhëzuesi i përgatitur dhe i publikuar.	3-mujore	100% Është hartuar udhëzuesi i Arsimit Fillor dhe është publikuar në faqen zyrtare të ASCAP dhe është dërguar në të gjitha ZVA-të dhe DRAP-et.
1.4	Të zbatojë platformën "Një ditë në shkollë" për analizën e vlerësimit të	1.4.1	Hartimi i analizës "Një ditë në shkollë", për AML. (I mbartur nga viti 2020 për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19).	Analiza e të dhënave të mbledhura nga instrumentet përkatëse dhe hartimi i plotë i materialit për analizën.	Përgatitja e analizës dhe publikimi i saj në faqen zyrtare të ASCAP.	3-mujore	100% Ka përfunduar vlerësimi brendshëm i kurrikulës për arsimin e mesëm të lartë dhe është publikuar në faqen zyrtare të ASCAP. Ky material u diskutua

	kurrikulës së zbatuar në AML						gjithashtu edhe në konferencën kombëtare të organizuar nga ASCAP dhe UNICEF në korrik 2021 ku morën pjesë përfaqësues nga MAS, donatorë, drejtues rrjetesh profesionale, specialist të ZVA-ve, DRAP-eve, DPA-së.
1.5	Të hartojë planin e veprimit për aftësitë digjitale në arsim bazuar në dokumentin "Action Plan for digjital Education 2021 – 2027" të Komisionit Europian.	1.5	Hartimi I draftit të planit të veprimit për aftësinë digjitale.	Ngrihet grupi i punës dhe hartohet plani i veprimit për zhvillimin e aftësive digjitale. Ky draft plan dërgohet në MAS.	Draft Plani I përgatitur.	Vjetore	100% Ka përfunduar drafti i përkthimit dhe përpunimit të Planit të veprimit 2021 -2027.

1.6	Të kryejë studimin mbi vlerësimin e nxënësit bazuar në kompetenca, në AMU.	1.6.1	Hartimi i instrumentit dhe studimit lidhur me vlerësimin e nxënësit bazuar në kompetenca në AMU.	Ngrihet grupi i punës, realizimi i studimit të përgatitur.	Studimi i përfunduar dhe publikuar.	Vjetore	80 % Grupi i punës ka hartuar instrumentin e vlerësimit të nxënësit bazuar në kompetenca dhe ka zhvilluar pyetësorin me mësues dhe drejtues të shkollave. Është në proces hartimi i raportit.
1.7	Të hartojë materiale tutoriale për përdorimin e platformave *zoom, google forms, gjeogebra, desmos, mathtype etj.*	1.7.1	Hartimi i materialeve tutoriale për përdorimin e platformave online në procesin mësimor.	Përgatit material për mësuesit për platforma online ose programe të cilat mbështesin mësuesit në rritjen e cilësisë së procesit të mësimdhënies – nxënies.	Platforma akademi.al, zoom, google forms, geogebra, desmos, mathtype etj.	9-mujore	100% Kanë përfunduar materialet tutorial për platformat akademi.al, zoom, google forms, geogebra, desmos, mathtype dhe janë publikuar në faqen zyrtare të ASCAP dhe janë dërguar në të gjitha ZVA-të dhe DRAP-et.
1.8	Të hartojë programet orientuese të maturës	1.8.1	Hartimi i programeve orientuese për vitin shkollor 2021 – 2022.	Hartohen të gjitha programet orientuese për vitin shkollor 2021-2022 lidhur me provimet kombëtare.	Programet orientuese të klasave V, IX, XII.	9-mujore	100% Janë hartuar dhe janë dërguar në MAS dhe QSHA 26 programe orientuese për provimet

	shtetërore për vitin shkollor 2021-2022.						kombëtare të klasave V, IX dhe XII.
1.9	Të realizohet redaktimi shkencor dhe sigurimi i cilësisë së videove që do të publikohen në Radio Televizionin Shqiptar – Shkolla si dhe në platformën akademi.al.	1.9.1	Redaktimi shkencor dhe letrar i videove për RTSH dhe platformën akademi.al.	Realizohet redaktimi shkencor dhe letrar i videove për publikimin në RTSH dhe në platformën akademi.al.	500 video të redaktuara.	Vjetore	100% Ka përfunduar redaktimi shkencor për rreth 6000 PowerPoint që janë realizuar videot. Të gjitha materialet e redaktuara, databaza dhe raporti janë dërguar në MAS.
1.10	Të hartojë modulet e trajnimit për mësuesit që japin mësim në	1.10.1	Hartimi i moduleve për trajnimin e mësuesve të klasës 12.	Hartohen modulet e trajnimit për mësuesit që japin mësim në klasat e 12-ta për lëndët gjuhë shqipe, letërsi dhe matematikë për vlerësimin	Modulet e hartuara.	3-mujore	100% Janë hartuar modulet për lëndët gjuhë shqipe, letërsi dhe matematikë për klasën e 12-të dhe janë akredituar nga KAPT.

	klasat e 12-ta për lëndët gjuhë shqipe, letërsi dhe matematikë për vlerësimin formues të nxënësit në koherencë me provimet e maturës shtetërore.			formues të nxënësit në koherencë me provimet e maturës shtetërore.			
1.11	Të hartohen dhe përshtaten modulet e trajnimit për mësuesit e shkollave pilot për zbatimin e kurrikulës për median dhe informimin.	1.11.1	Hartimi i moduleve për zbatimin e kurrikulës për median dhe informimin.	Hartohen dhe përshtaten modulet e trajnimit të mësuesve për median dhe informimin duke përfshirë edhe situatën e krijuar nga pandemia COVID 19 si një nga çështjet që sundon në mediat e sotme.	Modulet e hartuara.	Vjetore	100% Janë hartuar modulet e trajnimit. Janë zhvilluar disa takime me mësuesit e shkollave pilot për zbatimin e kurrikulës për median dhe informimin si dhe është realizuar mentorimi i tyre për zbatimin e këtyre koncepteve.

Objektivi 2 i përgjithshëm: Zhvillimi profesional i drejtuesve dhe mësuesve për të përmirësuar cilësinë e procesit të mësimdhënies-nxënies.							
2.1	Të organizojë procesin e kualifikimit të mësuesve 2021.	2.1.1	Ngritja e grupit të punës, Përgatitja e databazave për kualifikimin e mësuesve 2021.	Përgatitet databaza në nivel kombëtar për kualifikimin e mësuesve.	3000 mësues të planifikuar për testim.	3-mujore	100% Ka përfunduar procesi i kualifikimit të mësuesve 2021 dhe është hartuar raporti final. Databaza e mësuesve të kualifikuar dhe raporti janë dërguar në MAS. Të gjitha rezultatet e mësuesve që janë kualifikuar janë përcjellë pranë DPAP-së, DRAP-eve dhe ZVA-eve përkatëse. Gjatë vitit shkollor 2020 – 2021 fituan kategorinë e kualifikimit 3778 mësues nga 3912 që u paraqitën në testim.
		2.1.2	Përgatiten fondet dhe testet sipas profileve/lëndëve për kualifikimin e mësuesve, raporti i kualifikimit.	Hartimi i 40 fondeve dhe testeve për kualifikimin e mësuesve 2021.	40 fonde/teste të hartuara.	Vjetore	
2.2	Të koordinojë punën e KAPT.	2.2	Koordinimi i takimeve të KAPT	Koordinohet puna e Komisionit të Akreditimit të Programeve të Trajnimit.	Dokumentimi i takimeve të KAPT.	Vjetore	100% Është miratuar udhëzimi i Zhvillimit Professional të punonjësve arsimorë. Gjatë periudhës shtator – dhjetor 2021

							është zhvilluar faza e parë e vlerësimit të aplikimeve të sjella nga agjencitë trajnuese. Procesi i akreditimit të moduleve do të vijojë edhe gjatë vitit 2022.
2.3	Të mbështesë testimin e informatizuar "Mësues për Shqipërinë" nëpërmjet pjesëmarrjes në komisionet e provimeve.	2.4.1	Hartimi i fondit të provimit të Mësues për Shqipërinë. Pjesëmarrje në komisionet e testimit "Mësues për Shqipërinë".	Hartimi i fondeve dhe Komisionet sipas profileve/lëndëve.	Të paktën 25 profile/lëndë.	9-mujore	100% Ka përfunduar hartimi i fondit të pyetjeve "Mësues për Shqipërinë" dhe është dërguar në QSHA. Janë hartuar 24 fonde të pyetjeve për provimin e informatizuar "Mësues për Shqipërinë"
2.5	Të zhvillojë kapacitetet e drejtuesve të rrjeteve profesionale në arsimin bazë dhe arsimit të	2.5.1	Përgatitja e paketës së materialeve për trajnimin e drejtuesve të rrjeteve profesionale. Realizimi i trajnimeve me drejtuesit e rrjeteve profesionale.	Përgatitet paketa e materialeve për trajnimin e drejtuesve të rrjeteve profesionale dhe realizohet trajnimi i tyre.	Materialet e trajnimi dhe trajnimi i 1200 drejtues rrjetesh.	Vjetore	100% Janë trajnuar 1200 mësues të TIK për përdorimin e platformave online në procesin e të nxënit. Janë trajnuar 723 drejtues të rrjeteve profesionale të AMU për planifikimin e kurrikulës,

	mesëm lidhur me udhëzuesit, raportet, udhëzimet për zbatimin e kurrikulës, vlerësimin e nxënësit dhe zhvillimin profesional të mësuesve si dhe për përdorimin e platformave online në procesin mësimor.						metodologjinë e mësimdhënies, gjithëpërfshirjen dhe përdorimin e TIK në procesin e mësimdhënie – nxënies. Janë trajnuar 725 drejtues të rrjeteve profesionale për vlerësimin e nxënësve, mendimin kritik dhe zgjidhjen problemore. Janë hartuar raportet përkatëse të trajnimeve për secilën tematikë. Drejtuesit e rrjeteve profesionale kanë zhvilluar takime me anëtarët e rrjeteve profesionale për çdo temë për të cilën janë trajnuar. Të paktën 10000 anëtarë të rrjeteve profesionale kanë marrë pjesë në këto takime.
2.6	Të hartojë raportin e identifikimit të	2.6.1	Hartimi i raportit të identifikimit të nevojave të mësuesve.	Përpunohen të dhënat dhe hartohet raporti i identifikimit të nevojave nga grupi i punës.	Raporti I përgatitur.	3-mujore	100% Është hartuar Raporti kombëtar i "Identifikimit të nevojave të mësuesve për vitet 2021-2025".

	nevojave të mësuesve.						Ky material u diskutua gjithashtu edhe në konferencën kombëtare të organizuar nga ASCAP dhe UNICEF në korrik 2021 ku morën pjesë përfaqësues nga MAS, donatorë, drejtues rrjetesh profesionale, specialist të ZVA-ve, DRAP-eve, DPA-së.
2.7	Të trajnohen mësuesit e klasave 12-ta për lëndët gjuhë shqipe, letërsi dhe matematikë për vlerësimin formues të nxënësit në koherencë me provimet e maturës shtetërore.	2.7.1	Përgatitja e kalendarit dhe realizimi i trajnimeve.	Kalendari i trajnimeve dhe organizimi i trajnimeve.	700 mësues gjuhe dhe 600 mësues matematike të trajnuar.	6-mujore	100% Janë trajnuar 548 mësues të gjuhës shqipe dhe letërsisë, 488 mësues të matematikës. Gjithsej janë trajnuar 1036 mësues. Është hartuar raporti i trajnimeve dhe është dërguar në MAS.

2.8	Të koordinojë dhe të organizojë procesin e regjistrimit të mësuesve të gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë.	2.8.1	Përgatitja e njoftimeve, afati i aplikimeve, përgatitja e regjistrit.	Përgatitet njoftimi dhe caktohet afati I aplikimeve. Shqyrtohen aplikimet, vlefshmëria dhe përgatitet regjistri.	Regjistri i dërguar në MAS për miratim.	Vjetore	100% Ka dalë njoftimi në faqen e ASCAP për regjistrin e Diasporës 2021. Janë shqyrtuar dosjet e aplikantëve dhe bazuar në to është ndërtuar dhe regjistri i diasporës. Në pritje të miratimit të listës së aplikantëve nga MAS.
2.9	Të zhvillojë kapacitetet e ZVAP-ve dhe DRAP-eve lidhur me raportin e identifikimit të nevojave të mësuesve, udhëzimet e reja për zhvillimin	2.9.1	Organizimi i trajnimeve me specialistët e DRAP, ZVAP për udhëzimet e reja dhe raportin e identifikimit të nevojave të punonjësve arsimorë.	Trajnohen specialistët e DRAP, ZVAP për udhëzimet e reja të ZHVP dhe Kualifikimit si dhe për raportin e identifikimit të nevojave.	100 specialistë të DRAP dhe ZVAP.	Vjetore	100% Është realizuar Konferenca kombëtare për këtë veprimtari lidhur me zbatimin e kurrikulës, zhvillimit profesional dhe përdorimit të TIK. Gjithashtu në të gjitha takimet e drejtuesve të rrjeteve profesionale kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga ZVA-të dhe DRAP-et.

	profesional dhe kualifikimin e mësuesve.						
Objektivi 3 i përgjithshëm: Nxitja e arsimit cilësor dhe përmirësimi i gjithëpërfshirjes në edukim							
3.1	Të ngrihen kapacitetet e mësuesve ndihmës për mbështetje e nxënësve me nevoja të veçanta.	3.1.1	Ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të rrjeteve të mësuesve ndihmës.	Organizimi I trajnimit të 61 drejtuesve të rrjeteve të mësuesve ndihmës.	Të paktën 61 drejtues rrjetesh të mësuesve ndihmës.	Vjetore	100% Janë hartuar 4 module trajnimi për arsimin gjithëpërfshirës me fokus mbështetjen e mësuesve ndihmës që punojnë me nxënës me aftësi të ndryshe dhe me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. Trajnimet do të realizohen gjatë vitit 2022.
3.2	Të ngrihen kapacitetet e punonjësve të shërbimit psiko-social dhe oficerëve të	3.2.1	Hartimi i materialeve ndihmëse për punën e oficerëve të sigurisë.	Hartohen materiale ndihmëse për të lehtësuar punën e oficerëve të sigurisë.	Plane pune model.	Vjetore	100% Janë hartuar materialet ndihmëse për të lehtësuar punën e oficerëve të sigurisë dhe për shërbimin psiko-social dhe janë publikuar në faqen e ASCAP.
		3.2.2	Trajnimi i oficerëve të sigurisë mbi sjellje të ndryshme devijante	Trajnimi i oficerëve të sigurisë mbi aftësitë për parandalimin e përdorimit të drogës.	150 oficer sigurie të trajnuar.	Vjetore	

	sigurisë lidhur me veçoritë e moshës	3.2.3	Hartimi i materialeve ndihmëse për punën e shërbimit psiko-social.	Hartohen materiale ndihmëse për të lehtësuar punën e shërbimit psiko-social.	Manual mbi njohjen e abuzimit seksual.	Vjetore	Janë trajnuar 70 oficerë sigurie dhe 50 punonjës të shërbimit psiko-social. Është në vijim puna për trajnimin e tyre. Në bashkëpunim me ZVAP-të ASCAP ngriti 54 rrjete profesionale të shërbimit psiko-social dhe u krijua një bazë të dhënash që përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme në lidhje me ta. Për funksionimin e rrjeteve profesionale, ASCAP-i hartoi udhëzuesin për funksionimin e rrjeteve profesionale të shërbimit psiko-social së bashku me dokumentacionin mbështetës për punën e rrjeteve. 54 drejtues të rrjeteve të shërbimit psiko-social janë trajnuar për udhëzuesin për funksionimin e rrjeteve
		3.2.4	Trajnimi i punonjësve të shërbimit psiko-social mbi fenomenin e abuzimit seksual.	Trajnimi i punonjësve të shërbimit psiko-social mbi fenomenin e abuzimit seksual ku njihen me hapësirën ligjore, simptomat, pasojat, etj.	150 punonjës të shërbimit psiko-social të trajnuar.	Vjetore	

							profesionale. Puna e më shumë se 18 rrjeteve profesionale u mentorua nga ASCAP.
3.3	Organizimi i seminarit të përvitshëm mbi programin e integruar të mësimit shqip në diasporë.	3.3.1	Mbështetja e organizimit me palën e Kosovës.	Hartimi i veprimtarive të përbashkëta.	Agjenda, zhvillimi i seminarit.	9-mujore	Anuluar
OBJEKTIVA SHTESË GJATË VITIT 2021							
	Rishikimi i Videove për RTSH-shkolla që janë realizuar në periudhën shtator-dhjetor 2020.		Rishikimi i videove për RTSH për periudhën shtator-dhjetor 2020.	Ngrihet grupi I punës për realizimin e rishikimin e videove të atashuara në faqen zyrtare MAS në youtube.	Video mësimore të rishikuara.	3-mujore	100% Realizuar dhe dërguar në MAS. Është hartuar databaza dhe raporti përkatës për rishikimin e videove.
	Rishikimi teksteve shkollore.		Rishikimi teksteve shkollore.	Ngrihet grupi i punës për rishikimin e teksteve shkollore.	Raport për rishikimin e	3-mujore	90% Janë rishikuar tekstet shkollore sipas shtëpive botuese. Po vijon

					teksteve shkollore.		puna për përgatitjen e raportit final për MAS.
	Platforma për zhvillimin e kurrikulës së arteve dhe zejeve në arsimin parauniversitar.		Analiza e gjendjes aktuale të kurrikulës së arteve dhe zejeve.	Ngrihet grupi i punës për analizën e gjendjes aktuale të kurrikulës së arteve dhe zejeve në arsimin parauniversitar.	Platformë për zhvillimin e kurrikulës së arteve dhe zejeve.	Vjetore	90% Është përmbyllur plotësimi i analizës së të dhënave për artet dhe zejet në arsimin parauniversitar. Po vijon puna për analizën mbi vullnetarizmin në komunitet dhe në shkollë. Raporti përkatës është dërguar pranë Ministrisë së Shtetit për Fëmijët dhe Rininë si dhe në Kryeministri.
	Përfshira e gjuhës angleze në klasën e parë.		Hartimi i tre moduleve dhe trajnimi i mësuesve të gjuhës angleze klasa e parë.	Hartohen tre moduleve dhe trajnohen mësuesit e gjuhës angleze për klasën e parë.	Implementimi i gjuhës angleze në klasën e parë.	Vjetore	100% -Është hartuar materiali informues për programin e gjuhës anglez në klasën e parë. -Janë ngritur rrjetet profesional të mësuesve të gjuhës angleze për klasën e parë në nivel ZVA.

							- Janë trajnuar mësuesit në nivele ZVA për materialin informues për programin.
	Përfshirja e lëndës së Tik-ut që në klasën e parë në sistemin Parauniversitar.		Përfshirja e lëndës së Tik-ut që në klasën e parë në sistemin Parauniversitar.	Përgatitja e varianteve dhe mënyrave më të përshtatshme për implementimin e TIK në klasën e parë.	Përfshirja e Tik në klasën e parë.	Vjetore	Grupi i punës ka dërguar pranë MAS shkresën me variantet dhe mënyrat e propozuara për integrimin e lëndës së TIK-ut në klasat I-III. Pas marrjes së konfirmimit nga ana e MAS-it për përzgjedhjen e variantit të propozuar, grupi i punës do të filloje hulumtimin rreth hartimit të programit mësimor.
	Implementimi i kurrikulave në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar-SMIP.		Të shtohen në sistemin SMIP kurrikulat, të cilat aplikohen në sistemin arsimor parauniversitar.	Përfshirja e kurrikulave të arsimit parauniversitar në sistemin SMIP.		3-mujor	100% Në sistemin e menaxhimit të informacionit parauniversitar janë hedhur të gjithë kurrikulat, të cilat aplikohen në sistemin arsimor parauniversitar publik.

	Pjesëmarrja e Shqipërisë në TALIS 2024.		Përfshirja e Shqipërisë në TALIS 2024.	Aplikimi dhe pilotimi i TALIS 2024.			20% Grupi I Punës ka ndjekur të gjitha takimet e realizuara nga organizatorët e Talis. Po vijon puna për përgatitjen e Shqipërisë për pilotimin e TALIS.

III. DREJTORIA E PERFORMANCËS

3.1. Vizioni

Vizioni i DP është garantimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar me qendër nxënësin, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe konsolidimit e mëtejshëm shoqërisë shqiptare.

3.2. Qëllimi

Për përmbushjen e vizionit të saj, Drejtoria e Performancës ka si qëllim kryesor vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar, si dhe vlerësimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të institucioneve të arsimit parauniversitar në Shqipëri.

3.3. Vlerësimi i sistemit

Vlerësimi i sistemit është përdorimi i mjeteve të shumëfishta për të zhvilluar një pamje të përgjithshme të performancës arsimore. Kjo gjë e pajis publikun me informacionin e nevojshëm se si po performon sistemi i arsimit, si formë llogaridhënie dhe i pajis hartuesit e politikave me njohurinë e duhur për të ndikuar vendimmarrjet politike.

Fusha e veprimit në procesin e vlerësimit të performancës së sistemit përfshin:

Së pari, vlerësimin e nivelit të realizimit të veprimtarive në kuadër të politikave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit - SKA.

Procesi vlerëson performancën e sistemit arsimor parauniversitar në raport me objektivat e vendosura për realizimin e qëllimit të politikave në fushën e arsimit parauniversitar në kontekstin e zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi.

Së dyti, vlerësimi i mënyrës së organizimit e të funksionimit të sistemit arsimor parauniversitar.

Brenda kësaj fushe procesi lidhet me evidentimin e rasteve të mbivendosjes së funksioneve apo me vakumin e krijuar në funksionimin e institucioneve përgjegjëse të arsimit dhe me koordinimin/ndërveprimin reciprok të institucioneve, për të garantuar një nivel të qëndrueshëm integrim ndërinstitucional në funksion të sigurimit të cilësisë.

Mjetet kryesore për vlerësimin e sistemit përfshijnë:

• Treguesit kryesorë që përcaktojnë mbledhjen e informacionit kyç të monitorimit

• Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe analizat e rezultateve

• Vlerësimet e bëra nga programet dhe politikat specifike (OECD, PISA, etj.)

Treguesit e nivelit të sistemit parashikohen në Pasaportën e treguesve kombëtarë, si pjesë e SKA-së. Të dhënat e vlerësimit do të shërbejnë si të dhëna për DP për analiza të zgjeruara të rezultateve të nxënësve.

3.3.1. Vlerësimet kombëtare

Vlerësimet kombëtare në Shqipëri kryhen në tre nivele:

- Vlerësimi kombëtar i klasave të pesta;
- Vlerësimi kombëtar i klasave të nënta-Provimi i Lirimit;
- Matura Shtetërore.

3.3.2. Vlerësimet ndërkombëtare

Përveç këtyre vlerësimeve, Shqipëria merr pjesë në Programin për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA). Ajo ka marrë pjesë në PISA 2000, 2009, 2012, 2015 dhe 2018. Me gjithë përmirësimet në renditje, rezultatet janë akoma poshtë mesatares së vendeve të OECD.

Vlerësimet nga programet/politikat specifike

DP do të analizojë treguesit për raportin e përgjithshëm të performancës së arsimit dhe do të do të jetë një burim i rëndësishëm i kapacitetit analitik në sistemin arsimor. DP do të vlerësojë rezultatet në raport me pritshmëritë dhe do të japë propozimet përkatëse për MAS. DP do të bëjë krahasimin e rezultateve të nxënësve shqiptarë në PISA me rezultatin mesatar të vendeve të OECD dhe do të japë propozimet përkatëse. Në vlerësimin e programeve dhe partneriteteve një rol të rëndësishëm luan dhe INSTAT, i cili kontribuon me analizat për sfidat kryesore të sistemit arsimor të Shqipërisë.

3.3.3. Dokumentet e vlerësimit

Drejtoria e Performancës do të kryejë vlerësimin dhe garantimin e performancës së sistemit arsimor. ASCAP do të prodhojë raportin e përgjithshëm të performancës së sistemit të arsimit në nivel kombëtar me këshillimet përkatëse për MAS dhe institucionet e varësisë, institucionet arsimore dhe grupet e partneritetit/interesit.

Për ta realizuar në mënyrë profesionale këtë vlerësim ASCAP, nëpërmjet Drejtorisë së Performancës, ka hartuar draftet e dokumenteve bazë të vlerësimit ku përfshihen:

- Manuali i vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar;
- Metodologjia e vlerësimit së sistemit arsimor parauniversitar;
- Manuali i vlerësimit të institucioneve/njësive të arsimit parauniversitar;
- Metodologjia e vlerësimit të institucioneve/njësive të arsimit parauniversitar.

Hapi i parë ka qenë përfundimi i hartimit të dy dokumenteve të vlerësimit të përformancës së sistemit: Manualit dhe Metodologjisë së vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar, të cilat janë në proces miratimi nga MAS.

Hapi i dytë është përfundimi i hartimit të dy dokumenteve të vlerësimit të përformancës së institucioneve/njësive arsimore, të cilat do të dërgohen për miratim në MAS.

3.4. Detyrat kryesore të Drejtorisë së Performancës

DP kryen detyrat, si më poshtë:

a) Vlerëson performancën e sistemit arsimor parauniuversitar, efektshmërinë dhe eficencën e masave, si dhe përmbushjen e objektivave;
b) Vlerëson mënyrën e organizimit e të funksionimit të sistemit arsimor parauniversitar dhe merr masat e nevojshme në rast mbivendosjesh funksionesh ose mungese ekzekutimi të detyrave funksionale nga instucionet përgjegjëse;
c) Vlerëson se si institucionet e varësisë ndërlidhen/koordinohen/ndërveprojnë me njëri tjetrin, duke garantuar nivelin e duhur të integrimit për sigurimin e arsimit parauniversitar cilësor;
d) Vlerëson gjendjen e mjedisit fizik/infrastrukturës dhe mjaftueshmërinë e burimeve, duke propozuar edhe masat e nevojshme;
e) Kryen analiza të ndryshme mbi bazën qendrore e të integruar të të dhënave të sistemit të arsimit parauniversitar;
f) Harton dhe siguron zbatimin e manualeve dhe metodologjive arsimore, në funksion të vlerësimit të performancës së sistemit.
g) Bashkërendon veprimtarinë e saj me drejtoritë dhe sektorët e tjerë të ASCAP, me ministrinë përgjegjëse për arsimin si dhe me institucione të tjera të të gjitha niveleve brenda dhe jashtë vendit, për realizimin cilësor të detyrave të saj;
h) Mbështet kualifikimin dhe vetë-kualifikimin e stafit të drejtorisë.

3.5. Objektivat e përgjithshëm të Drejtorisë së Performancës

Objektivat e përgjithshëm të DP janë:

1. Vlerësimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar (vlerësimi i zbatimit të SKA-së).
2. Garantimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar (vlerësimi i zbatimit të masave të reja të marra).

3. Vlerësimi i performancës së institucioneve/njësive të sistemit arsimor parauniversitar (vlerësimi i mënyrës së organizimit e funksionimit të IAP).

3.6. Objektivat e detajuar

Objektivat e detajuar janë si më poshtë:

1. Formalizimi i Manualit të vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar.
2. Formalizimi i Metodologjisë së vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar.
3. Zbatimi i Manualit dhe Metodologjisë së vlerësimit të performancës së SAPU, në përshtatje me Strategjinë 2021-2026.
4. Hartimi i Manualit të vlerësimit të performancës së institucioneve të arsimit parauniversitar, qendrore, rajonale dhe vendore.
5. Hartimi i Metodologjisë së vlerësimit të performancës së institucioneve të arsimit parauniversitar, qendrore, rajonale dhe vendore.
6. Mbledhja dhe analiza e të dhënave të sistemit të arsimit parauniversitar mbi bazën qendrore e të integruar.
7. Vlerësimi i efektshmërisë dhe eficiencës së shërbimit të oficerëve të sigurisë në shkolla.
8. Vlerësimi i nivelit të funksionimit të shkollave si “Shkollë Qendër Komunitare”.

3.7. Veprimtaritë e DP

Për realizimin e objektivave gjatë vitit 2021, DP ka zhvilluar veprimtaritë si më poshtë:

3.7.1. Formalizimi/Miratimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës

- Përshtatja e terminologjisë së Manualit të Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar, me terminologjinë e Strategjisë së re të Arsimit Parauniversitar.
- Miratimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar nga MAS/ASCAP.
- Publikimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar nga ASCAP.

3.7.2. Formalizimi/Miratimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës

- Përshtatja e terminologjisë së Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar, me terminologjinë e Strategjisë së re të Arsimit Parauniversitar.
- Miratimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar nga MAS.
- Publikimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar nga ASCAP.

3.7.3. Hartimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës së Institucioneve/Njësive të AP, qendrore rajonale e vendore

- Hartimi i draftit paraprak të Manualit të Vlerësimit të Performancës së Institucioneve/Njësive të AP.
- Diskutimi i draftit të Manualit me specialistë të fushës dhe grupet e interesit.
- Hartimi i draftit përfundimtar të Manualit të Vlerësimit të Performancës së Institucioneve/Njësive të AP.

3.7.4. Hartimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, qendrore rajonale e vendore

- Hartimi i draftit paraprak të Metodologjisë së vlerësimit të performancës së institucioneve/njësive të AP.
- Diskutimi i draftit të Metodologjisë me specialistë të fushës dhe grupet e interesit.
- Hartimi i draftit përfundimtar të Metodologjisë së vlerësimit të performancës së institucioneve/njësive të AP.

3.7.5. Vlerësimi i masave të marra

3.7.5.1. Vlerësimi i shërbimit të oficerëve të sigurisë në shkolla

- Pyetësor me të gjithë oficerët e sigurisë që ofrojnë shërbim në shkolla.

- Pyetësor me fokus-grupe nxënësish për sigurinë në shkolla.
- Përpunimi dhe analiza e të dhënave.
- Raport për vlerësimin e shërbimit të sigurisë në shkolla.

3.7.5.2. Vlerësimi i nivelit të funksionimit të shkollave si "Shkollë Qendër Komunitare"

Drejtoria e Performancës ka hartuar një pyetësor, i cili nuk është zhvilluar për arsye të situatës së krijuar nga Covid-19. Kjo veprimtari do të zhvillohet në një periudhë të përshtatshme.

4.1 Tabela e veprimtarive të zhvilluara nga DP në periudhën 01 janar - 31 dhjetor 2022

DREJTORIA E PERFORMANCËS										
Nr.	**Objektivi i përgjithshëm**	**Nr.**	**Objektiva të detajuara**	**Nr.**	**Tregues**	**Përshkrimi i treguesit**	**Produkt**	**Frekuenca dhe mënyra e matjes**	**Personi përgjegjës**	**Realizimi i veprimtarive**
1.	Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të performancës së sistemit arsimor	**1.1**	Hartimi dhe publikimi i manualit dhe metodologjisë së vlerësimit të performancës	**1.1.1**	Hartimi i manualit të vlerësimit të performancës së SAPU.	Përshtatja e terminologjisë së draftit të manualit të vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar, me terminologjinë e	Manuali i vlerësimit të performancës i përshtatur me termat e draftit të SKA 2021-2026.	4-8 mujore, në varësi të kohës së miratimit	Bashkim Muça	Realizuar 100 %. Termat e manualit janë përshtatur me SKA-në.

	parauniversitar publik dhe privat.		së sistemit arsimor parauniversitar (SAPU).			Strategjisë Kombëtare të Arsimit – SKA, 2021-2026.		të SKA-së		
				1.1.2	Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të performancës së SAPU.	Përshtatja e terminologjisë së draftit të metodologjisë së vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar, me terminologjinë e Strategjisë së re të arsimit 2021-2026.	Metodologjia e vlerësimit të performancës e përshtatur me termat e Draftit të SKA 2021-2026.	4-8 mujore, në varësi të kohës së miratimit të SKA-së.	Bashkim Muça	Realizuar 100 %. Termat e metodologjisë janë përshtatur me SKA-në.
				1.1.3	Miratimi i manualit të vlerësimit të performancës në MAS.	Është hartuar relacioni përkatës, për draft/manualin dhe është dërguar për miratim në MAS.	Miratimi i manualit nga MAS	12-mujore	Bashkim Muça	Realizuar 100 %. manuali në procedurë miratimi.
				1.1.4	Miratimi i Metodologjisë së vlerësimit të	Është hartuar relacioni përkatës, për Draft/Metodologjinë dhe	Miratimi i Metodologjisë nga MAS.	12-mujore	Bashkim Muça	Realizuar 100 %.

					performancës në MAS.	është dërguar për miratim në MAS.				Metodologjia në proces miratimi.
				1.1.5.	Publikimi i Manualit dhe Metodologjisë të vlerësimit të performancës.	Manuali dhe Metodologjia do të publikohen pas miratimit nga MAS.	Manuali dhe Metodologjia e publikuar në faqen e ASCAP	12-mujore	Bashkim Muça	Do të publikohet në janar 2022.
		1.2	Trajnimi i punonjësve të institucioneve / njësive në nivel qendror, rajonal dhe vendor, për përgjegjësitë në zbatimin e Manualit dhe Metodologjisë së Vlerësimit të	**1.2.1**	Hartimi i Programit/Modulev e të trajnimit, me punonjësit e DPAP-së, DRAP-eve dhe ZVA-ve, për përgjegjësitë në zbatimin e Manualit dhe Metodologjisë.	Programi i trajnimit përmban 2 module, përkatësisht: Manualin dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Performancës.	Programi/Module t e trajnimit dërguar për akreditim nga KAPT.	12-mujore	Bashkim Muça dhe specialistët e Sektorit të Performancës	Realizuar 100 % Në zbatim të Udhëzimit Nr. 16 datë 28.07.2021 "Për organizmin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm
				1.2.2.	Hartimit i 3 temave të trajnimit për modulin: Manuali i	Temat e trajnimit janë hartuar në variantin PP për prezantim me	3 tema trajnimi në PP, për modulin Manuali i	12-mujore	Specialistët e Sektorit të	

			Performancës së SAPU.		Vlerësimit të Performancës.	punonjësit e njësive arsimore.	Vlerësimit të Performancës.		Performancës	profesional të punonjësve arsimorë", është hartuar Programi i Trajnimit, me 2 module dhe për secilin modul janë hartuar nga 3 tema trajnimi.
				1.2.3.	Hartimit i 3 temave trajnuese për modulin: Metodologjia e Vlerësimit të Performancës.	Temat e trajnimit janë hartuar në variantin PP për prezantim me punonjësit e njësive arsimore.	3 tema trajnimi në PP, për modulin Metodologjia e Vlerësimit të Performancës	12-mujore	Specialistët e Sektorit të Statistikës	
2.	Hartimi i dokumentev e të vlerësimit të performancë s së institucione ve/njësive të arsimit parauniversi	**2.1.**	Hartimi i Manualit të vlerësimit të performancës së institucioneve /njësive të	**2.1.1.**	Hartimi i draftit paraprak të Manualit të Vlerësimit të Performancës së IAP.	Integrimi i produkteve të grupeve të punës dhe hartimi i variantit paraprak të Manualit.	Drafti paraprak i Manualit.	4- mujore	Bashkim Muça dhe dy sektorët	Realizuar 100 %. Drejtoria e Performancës, ka ngritur grupin e punës i cili ka ndjekur të gjitha hapat
				2.1.2.	Diskutimi i draftit paraprak të Manualit të Vlerësimit të	Drafti i Manualit është diskutuar me grupet e interesit, nga ku	Marrja komenteve e sugjerimeve nga grupet e interesit.	6- mujore	Bashkim Muça dhe dy sektorët	

	tar, qendrore rajonale dhe vendore		arsimit parauniversitar, qendrore rajonale dhe vendore.	**2.1.3.**	Performancës së IAP me grupet e interesit. Diskutimi i Manualit të Vlerësimit Performancës së IAP me ekspertë të fushës.	reflektohen vërejtje dhe sugjerime. Drafti i Manualit është diskutuar me ekspertë, nga ku reflektohen vërejtje dhe sugjerime.	Marrja e komenteve e sugjerimeve nga ekspertët.	6- mujore	Bashkim Muça dhe dy sektorët	procedurale për hartimin e Manualit, si: - Përcaktimin e strukturës - Hartimin e draftit paraprak - Diskutimin e draftit me specialistë dhe grupe interesi. - Hartimin e draftit përfundimtar.
				2.1.5.	Reflektimi i komenteve e sugjerimeve nga grupet e interesit dhe ekspertët.	Komentet dhe sugjerimet janë reflektuar te Drafti i Metodologjisë.	Drafti me reflektimin e komenteve e sugjerimeve nga grupet e interesit dhe ekspertët.	6-9 mujore	Bashkim Muça dhe dy sektorët	
				2.1.5.	Hartimi i Draftit përfundimtar.	Pas reflektimit të të gjitha vërejtjeve dhe sugjerimeve të vlefshme nga aktorët kontribuues është hartuar drafti përfundimtar i Manualit.	Drafti përfundimtar i Manualit.	6-9 mujore	Bashkim Muça dhe dy sektorët	

		2.2.	Hartimi i Metodologjisë së vlerësimit të performancës së institucioneve /njësive) AP qendrore, rajonale dhe vendore.	**2.2.1.**	Përcaktimi i strukturës e Metodologjisë së vlerësimit të performancës së IAP.	Konsultimi i përvojave të ndryshme për Metodologjinë e vlerësimit IAP.	Struktura e Metodologjisë e përcaktuar.	6 - mujore	Bashkim Muça dhe dy sektorët	Realizuar 100 % Është zhvilluar e njëjta procedurë si në rastin e Manualit të Vlerësimit të Institucioneve /Njësive Arsimore. Drejtoria e Performancës, ka ngritur grupin e punës që ka ndjekur të gjitha hapat procedurale për hartimin e
				2.2.2.	Hartimi i Draftit paraprak të metodologjisë së vlerësimit njësive të arsimit parauniversitar.	Integrimi i produkteve të grupeve të punës dhe hartimi i Draftit paraprak të metodologjisë.	Drafti paraprak i metodologjisë.	8 -mujore	Bashkim Muça dhe dy sektorët	
				2.2.3.	Diskutimi i draftit të Metodologjisë së vlerësimit IAP me grupet e interesit.	Drafti i Drafti paraprak i Metodologjisë është diskutuar me grupet e interesit, nga ku reflektohen vërejtje dhe sugjerime.	Marrja e komenteve e sugjerimeve nga grupet e interesit.	Shtator - tetor 2021	Bashkim Muça dhe dy sektorët	
				2.2.4.	Reflektimi i komenteve e sugjerimeve nga	Drafti i Metodologjisë është diskutuar me	Marrja e komenteve e	Nëntor 2021	Bashkim Muça dhe dy sektorët	

					grupet e interesit dhe ekspertët.	ekspertë, nga ku reflektohen vërejtje dhe sugjerime.	sugjerimeve nga ekspertët.			Metodologjisë.
				2.2.5.	Hartimi i Draftit përfundimtar të metodologjisë së vlerësimit të performancës së IAP.	Pas reflektimit të vërejtjeve dhe sugjerimeve të vlefshme nga aktorët kontribuues është hartuar drafti përfundimtar i Metodologjisë.	Drafti përfundimtar i metodologjisë.	12-mujore Dhjetor 2021	Bashkim Muça dhe dy sektorët	Brenda muajit Janar 2022, dy dokumentet e vlerësimit të performancës së njësive arsimore do të dërgohen si paketë për miratim në MAS.
3.	Garantimi i performancës sistemit arsimor parauniversitar	**3.1**	Vlerësimi i efektshmërisë së shërbimit të Oficerëve të Sigurisë në shkolla.	**3.1.1**	Grumbullimi i të dhënave për efektshmërinë shërbimit të oficerëve të sigurisë në shkolla.	Monitorimi i eficiencës së oficerëve të sigurisë në gjimnaz nëpërmjet zhvillimit të një sondazhi online, me oficerët e sigurisë dhe	Përpunimi dhe analiza e të dhënave.	4- mujore	Redi Dengeri Ermal Kola	Realizuar 100 %

	nëpërmjet vlerësimit të masave të marra.					një kampion nxënësish të shkollave të mesme.			Erjola Shehaj Albina Nuredini	
				3.1.2	Vlerësimi i efektshmërisë së shërbimit të oficerëve të sigurisë në shkolla.	Vlerësimi i efektshmërisë së shërbimit të oficerëve të sigurisë në gjimnaze.	Raport vlerësimi	4- mujore	Lindita Çifçi Mirela Kondili Etleva Lundra	Realizuar 100 %. Është hartuar dhe publikuar Raporti i Vlerësimit me rekomandimet përkatëse.
		3.2	Vlerësimi i efektshmërisë shkollave si "Shkolla Qendër Komunitare"	**3.2.1**	Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për eficiencën e funksionimit të shkollave si	Monitorimi i eficiencës së funksionimit të shkollave si "Shkollë Qendër Komunitare" nëpërmjet zhvillimit të një pyetësori.	Pyetësor i hartuar për monitorimin e funksionimit të shkollave si "Shkollë Qendër Komunitare".	6- mujore	Redi Dengeri Ermal Kola Erjola Shehaj	Realizuar 50 %. Kjo veprimtari është shtyrë

					"Shkollë Qendër Komunitare".				Adela Iljazi Albina Nuredini	për shkak të Covid-19 dhe do të kryhet në një kohë të përshtatshme.
				3.2.2	Vlerësimi i eficiencës së funksionimit të shkollave si "Shkollë Qendër Komunitare".	Vlerësimi i eficiencës të shkollave si "Shkolla Qendër Komunitare".	Raport vlerësimi	8- mujore	Etleva Lundra Mirela Kondili Lindita Çifçi	Për shkak të Covid-19 do të kryhet në një kohë të përshtatshme.

IV. DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË

4.1 Gjendja aktuale

Drejtoria e vlerësimit të cilësisë funksionon si pjesë përbërëse e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimit Parauniversitar (ASCAP) është krijuar në përputhje me VKM nr. 98 datë 27.02.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar". Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë (DVC), ka në fokusin e saj monitorimin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, publik dhe privat, si dhe programet e tyre mësimore, në bashkërendim me drejtoritë e tjera të ASCAP-it.

Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë ka qenë dhe mbetet një ndër sfidat e përhershme të sistemeve arsimore, në kushtet e ndryshueshmërisë në kohë të konceptimit të saj, nëpërmjet udhëzuesve/protokolleve të përmirësuara dhe të përditësuara të cilat e definojnë objektivisht atë.

4.1.1 Vlerësimi i cilësisë së kurrikulës

Kurrikula e reformuar, mbështetur në qasjen me kompetenca po zbatohet në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar. Monitorimi dhe vlerësimi mbi bazë risku i DRAP-eve, ZVAP-ve dhe IAP-ve, është ndër kushtet e vijimit të suksesshëm të saj, duke realizuar edhe punë kërkimore-studimore, analiza periodike, të cilat mundësojnë ofrimin e ekspertizës për strukturat politike vendimmarrëse dhe për reformat në fushën e arsimit parauniversitar. Monitorimi dhe vlerësimi në vijimësi i zbatimit të kurrikulës në lloje, nivele dhe cikle të ndryshme shkollimi, i kushteve dhe detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor të institucioneve, apo gjithë sistemit arsimor parauniversitar për kurrikulën, standardet, metodologjinë, mundëson përmirësimin e sistemit nëpërmjet këshillimeve dhe rekomandimeve në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Udhëzuesit/protokollet e hartuara dhe të përditësuara nga Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë sigurojnë progresin e performancës së DRAP-eve, ZVAP-ve, IAP-ve publike dhe private nëpërmjet zbatimit të vlerësimit të jashtëm dhe vlerësimit të brendshëm.

4.1.2 Organizimi dhe drejtimi i institucioneve arsimore

Organizimi, drejtimi, bashkëpunimi institucional dhe ndërinstitucional, është risi që mundëson realizimin e misionit, detyrave dhe përgjegjësive të secilit për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së IAP-ve dhe sistemit si i tërë.

Organizimi dhe drejtimi i institucioneve arsimore, duhet të jetë në vëmendje të përhershme të monitorimit dhe vlerësimit për vetë impaktin që përcjell në perfomancën e institucioneve arsimore publike dhe private, nëpërmjet punëve kërkimore-studimore dhe analizave periodike.

4.2 Vizioni

Vizioni i DVC-së është përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar në sistemin arsimor parauniversitar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), nëpërmjet zbatimit të udhëzuesve/protokolleve bashkëkohore, kontekstuale në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.3 Misioni

Misioni i DVC-së është monitorimi dhe vlerësimi i sigurimit të cilësisë në sistemin arsimor parauniversitar, duke hartuar udhëzuesit/protokollet përkatëse vlerësuese në mbështetje të procesit të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të IAP-ve publike dhe private, nëpërmjet një pune kërkimore-studimore, analizave periodike për një vlerësim objektiv në bazë të regjistrit të riskut.

4.4 Vlerat drejtuese

DVC-ja udhëhiqet nga këto vlera drejtuese:

- "Agjent i ndryshimit" për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar, nëpërmjet vlerësimit, raportimit, këshillimit, në bazë të parimeve të proporcionalitetit, paanshmërisë, pavarësisë, për arritjen e qëllimit të sistemit arsimor parauniversitar në përputhje me strategjinë e SAPU-së;
- Ndërmerr iniciativa dhe propozon përmirësime në politikat për monitorimin e vlerësimin e cilësisë, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në performancën e shkollës dhe sistemit arsimor në tërësi duke përzgjedhur dhe përhapur praktika të suksesshme;
- Mbështet profesionalisht stafet e DPAP-së, DRAP-ve, ZVAP-ve dhe të institucioneve arsimore në zbatimin e udhëzuesve/protokolleve të vlerësimit të jashtëm dhe vlerësimit të brendshëm në IAP-ve publike dhe private;
- Mbështet profesionalisht drejtimin dhe organizmin e shkollës si element kyç në përmirësimin e performancës së saj.

4.5 Detyrat kryesore të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë

Detyrat kryesore janë:

a) harton, analizon dhe rishikon udhëzuesit e inspektimit, monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së institucionit përgjegjës për arsimin për ofrimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar si dhe të institucioneve arsimore publike dhe private mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) vlerëson dhe monitoron mbi bazë risku veprimtarinë e institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar, për respektimin në vazhdimësi të kushteve dhe detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor, shoqëruar me lënien e detyrave/sugjerimeve/rekomandimeve për përmirësimin e elementeve të caktuar të institucioneve apo gjithë sistemit të arsimit parauniversitar, si: kurrikul, standarde, metodologji, drejtim institucioni etj.;

c) vlerëson dhe monitoron mbi bazë risku veprimtarinë e institucioneve arsimore publike dhe private të sistemit të arsimit parauniversitar, për respektimin në vazhdimësi të kushteve dhe detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor, shoqëruar me lënien e detyrave/sugjerimeve/rekomandimeve për përmirësimin e elementëve të caktuar të institucioneve apo gjithë sistemit të arsimit parauniversitar, si: kurrikul, standarde, metodologji, drejtim institucioni etj.;

d) monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës në lloje, nivele e cikle të ndryshme shkollimi;

e) kontrollon përputhshmërinë me ligjin për veprimtaritë e agjencive trajnuese ose të organizatave që ofrojnë trajnime për punonjësit arsimorë;

f) vlerëson cilësinë e trajnimeve të ofruara nga agjencitë që kanë akredituar programe/module trajnimi për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;

g) këshillon dhe jep rekomandime për njësitë vendore arsimore dhe për institucionet arsimore, në lidhje me përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor;

h) përzgjedh dhe përhap praktikat e suksesshme të institucioneve arsimore nëpërmjet faqes zyrtare të ASCAP-it ose botimeve;

i) informon dhe raporton nëpërmjet raporteve të vlerësimit të cilësisë, letrave informuese, komunikimit online dhe botimeve, ministrin përgjegjës për arsimin, institucionet e varësisë së ministrisë për arsimin, njësitë vendore arsimore, bashkitë për shkollat që kanë nën juridiksion, institucionet arsimore;

j) kontribuon në formulimin ose në rishikimin politikave dhe të strategjive arsimore, si dhe në vendimmarrjet në fushën e reformave arsimore, mbi bazën e gjetjeve dhe informacioneve nga monitorimet;

k) bashkëpunon me drejtoritë e tjera të ASCAP-it në funksion të përmbushjes me cilësi të qëllimeve dhe të funksioneve të ASCAP-it;

l) mundëson dhe mbështet kualifikimin dhe vetë-kualifikimin e stafit të drejtorisë;

m) bashkëpunon me organizata kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për veprimtari apo aktivitete që lidhen me detyrat saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

4.6 Objektivat e përgjithshëm për periudhën janar-dhjetor 2021

DVC-ja ka këto objektiva të përgjithshme:

- Të hartohen manuale/udhëzues për vlerësimin e institucioneve arsimore parauniversitare.
- Të vlerësohen institucionet arsimore parauniversitare për cilësinë e zbatimit të kurrikulës.
- Të fuqizohet ngritja e kapaciteteve të DPAP/DRAP/ZVAP-ve dhe drejtuesve e ekipeve lëndore të shkollave.

4.7 Objektivat e detajuar për periudhën qershor-dhjetor 2021

DVC-ja ka këto objektiva të detajuar:

1. Të hartohet Korniza e vlerësimit të cilësisë së kopshtit.
2. Të hartohet udhëzuesi për vlerësimin e kompetencave profesionale të vlerësuesve të DRAP-eve/ZVAP-ve.
3. Të hartohet Manuali për vlerësimin mbi bazë risku të IAP-ve.
4. Të rishikohen treguesit e KPSH-së dhe të botohet KPSH-ja e riparë.
5. Të hartohen pyetësorët për nxënësit, prindërit dhe mësuesit në lidhje me veprimtarinë mësimore edukative të IAP-së.
6. Të hartohet Manuali për vlerësimin e agjencive trajnuese
7. Të vlerësohen IAP-të për cilësinë e zhvillimit të mësimit në kushtet e pandemisë.
8. Të vlerësohet cilësia e zbatimit të kurrikulës në fushën e shkencës dhe TIK-ut.
9. Të trajnohen specialistët e DRAP-eve/ZVAP-ve, për paketën e vlerësimit të cilësisë së shkollës.
10. Të trajnohen drejtuesit dhe kryetarët e ekipeve lëndore të shkollave publike dhe jopublike për procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.
11. Të ngrihet rrjeti profesional i vlerësuesve.

4.8 Tabela e veprimtarive të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË										
Nr.	**Objektivi i përgjithshëm**	**Nr.**	**Objektiva të detajuara**	**Nr.**	**Tregues**	**Përshkrimi i treguesit**	**Produkt**	**Frekuenca dhe**	**Personi përgjegjës**	**Realizimi i veprimtarive**

								mënyra e matjes		
1.	**Hartimi i manualeve/ udhëzuesve për vlerësimin e institucione ve arsimore.**	**1.1**	Të rishikohen treguesit e KPSH-së dhe të botohet KPSH-ja e riparë.	**1.1.1.**	Rishikimi i treguesve bazuar tek raporti i vlerësimit të KPSH-së. Ngritja e grupeve të punës për përmirësimin e dokumentit, bazuar tek kriteret e paracaktuara. Rishikimi i draftit të ri.	Nxirren pikat në të cilat ndërhyhet për përmirësim nga raporti kombëtar i vlerësimit të zbatimit të KPSH-së, i realizuar nga DVC-ja në qershor 2020. Grupet e punës punojnë për të përcaktuar mënyrën se si do përmirësohet produkti, duke marrë në konsideratë procesin e implementimit dhe përputhjen me kuadrin ligjor të përditësuar. Tryeza të rrumbullakëta me specialistë të DRAP/ZVAP-ve mësues dhe drejtues shkolle.	KPSH-ja	Vjetore	DVC	KPSH-ja është dërguar në MAS për miratim.
		1.2.	Të hartohen Standardet profesionale të	**1.2.1.**	Reflektimi i komenteve të grupeve të interesit.	Reflektimi i komenteve të grupeve të interesit. Standardet përfundimtare.	Standardet profesionale të vlerësuesit të IAP-ve.	Mars 2021	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, SH. Muça.	U përgatit dokumenti përfundimtar dhe u miratua nga MAS-ja.

			vlerësuesit të IAP-ve							
		1.3.	Të hartohet Korniza për Vlerësimin e Cilësisë së kopshtit.	**1.3.1.**	Konsultimi i KVCK-së me grupet e interesit. Hartimi i draftit përfundimtar.	Konsultimi i KVCK-së me specialistë të DPAP-së, DRAP-eve, ZVAP-eve, njësive përgjegjëse për arsimin pranë bashkive, si dhe me drejtues dhe mësues të arsimit parashkollor.	Draft Korniza për Vlerësimin e Cilësisë së Kopshtit.	Vjetore	E. Veli, M. Ucaj.	Është hartuar draft Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së kopshtit.
		1.4.	Të hartohet Manuali i riskut.	**1.4.1.**	Ngritja e grupit të punës për hartimin e manualit të riskut. Studimi i përvojave ndërkombëtare. Analizë krahasuese.	Ngihet grupi i punës pranë ASCAP për hartimin e Manualit të riskut. Realizohet analiza krahasuese bazuar në përvojat ndërkombëtare. Përcaktimi i matricës së riskut dhe përzgjedhja e faktorëve të riskut.	Draft/Manuali i riskut.	Vjetore	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, SH. Muça.	Është në proces hartimi i draftit paraprak të Manualit të riskut. Përfundimi i manualit parashikohet në muajt e parë të 2022, pasi DVC ka realizuar

										detyra të tjera jashtë planit.
		1.5.	Të hartohen Standardet Profesionale të drejtuesve të arsimit parashkollor.	**1.5.1**	Analizë krahasuese. Draft standardet profesionale të drejtuesve të arsimit parashkollor.	Realizohet analiza krahasuese bazuar në përvojat ndërkombëtare. Përcaktohen draft standardet.	Draft standardet	Korrik 2021	E. Veli, M. Ucaj	Janë hartuar draft standardet profesionale të drejtuesve të arsimit parashkollor në bashkëpunim me drejtorinë e kurrikulës.
		1.6.	Të hartohet Udhëzuesi për ngritjen dhe funksionimin e rrjetit të vlerësuesve.	**1.6.1.**	Ngritja e grupit të punës për hartimin e udhëzuesit. Studimi i përvojave kombëtare e ndërkombëtare, si dhe i akteve	Ngihet grupi i punës për hartimin e udhëzuesit për ngritjen dhe funksionimin e rrjetit të vlerësuesve. Përcaktohen mënyra e funksionimit të rrjetit të vlerësuesve si dhe detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e vlerësuesve.	Draft udhëzuesi	Vjetore	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, SH. Muça	Është në proces hartimi i draftit të parë të udhëzuesit.

					ligjore e nënligjore në fushën e arsimit parauniversitar.					
		1.7.	Të hartohen listat e verifikimit për sistemin e inspektimi.	**1.7.1.**	Evidentimi i akteve ligjore e nënligjore të përditësuara. Ngritja e gupeve të punës për hartimin e listë verifikimeve. Hartimi i listë verifikimeve.	Evidentimi i akteve ligjore e nënligjore të përditësuara. Hartimi i listave të verifikimit për realizimin e inspektimeve online, përkatësisht për : - Udhëzimin nr. 4, datë 26.02.2021, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve". - Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social", i	Listat e verifikimit	Vjetore	DVC	U dorëzuan pranë Inspektoratit Qendror 6 listë verifikimet.

						ndryshuar me Urdhrin nr. 23, datë 23.12.2020. - Urdhrin nr. 46, datë 16.3.2021, “Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1, 2, 3, 4, 8, 9, 10, 11, 12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2021-2021”. - Udhëzimin nr. 30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 14 datë 28.07.2021. - Udhëzimin nr. 12, datë 10.06.2021, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të				

						mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë". - Udhëzimin nr. 16, datë 28.07.2021 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë**".**				
2.	**Vlerësimi i IAP-ve.**	**2.1.**	Monitorimi i IAP-ve për cilësinë e zhvillimit të mësimit në kushtet e pandemisë.	**2.1.1**	Hartimi i metodologjisë dhe platformave për monitorimin e IAP-ve. Hartimi i pyetësorëve për mësues, nxënës, prindër.	Hartohet metodologjia dhe platforma e monitorimit për vlerësimin e cilësisë që ofron shkolla për zhvillimin e mësimit në kushtet e pandemisë, bazuar në skenarët 2 e 3. Hartohen pyetësorët për mësues, nxënës dhe prindër për të vlerësuar kënaqësinë/shqetësimet e tyre për	Raporti për çdo shkollë të monitoruar. Raporti përmbledhës.	Shkurt 2021	DVC/DPAP/ DRAP	Janë monitoruar me kampionim 18-të IAP në ZVAP-të Tiranë, Shkodër, Korçë, Fier, Gjirokastër,

					Ngritja e grupeve të monitorimit. Monitorimi i IAP-ve.	zhvillimin e mësimit në kushtet e pandemisë. Ngihen grupet e monitorimit në bashkëpunim me DPAP-në.				Durrës, Lezhë, Elbasan dhe Kamzë. Procesi u ndërpre për shkak të pandemisë.
		2.2.	Monitorimi ZVAP-ve për masat e marra për zhvillimin e mësimit në kushtet e pandemisë.	**2.2.1**	Hartimi i metodologjisë dhe platformës për monitorimin e ZVAP-ve. Ngritja e grupeve të monitorimit. Monitorimi i ZVAP-ve, sipas platformave së vlerësimit.	Hartohet metodologjia dhe platforma e monitorimit. Ngrihen grupet e monitorimit në bashkëpunim me DPAP-në, me përfshirjen e specialistëve të DVC-së dhe specialistë të DRAP-eve/ZVAP-ve.	Raporti për secilën ZVAP të monitoruar. Raporti përmbledhës.	Shkurt 2021	DVC	Janë monitoruar 9-të ZVAP, përkatësisht: ZVAP-të Tiranë, Shkodër, Korçë, Fier, Gjirokastër, Durrës, Lezhë, Elbasan dhe Kamzë. Procesi u

										ndërpre për shkak të pandemisë.
		2.3.	Monitorimi i shkollave për masat e marra në fillimin e vitit shkollor 2021-2022.	**2.3.1**	Hartimi i platformës së monitorimit. Hartimi i treguesve të monitorimit. Hartimi i raportit të monitorimit në rang kombëtar.	Hartohet platforma e monitorimit për masat e marra nga shkolla në fillimin e vitit shkollor 2020-2021. Ngrihen grupet e monitorimit në bashkëpunim me MAS.	Raporti përmbledhës	Shtator 2021	MAS/DVC	Janë monitoruar 69 shkolla në nivel kombëtar. Është hartuar raporti përmbledhës.
		2.4.	Monitorimi i ZVAP-ve për zbatimin e procedurave të emërimit të mësuesit në një vend	**2.4.1.**	Hartimi i platformës. Hartimi i raportit për çdo ZVAP. Hartimi i raportit të monitorimit në rang kombëtar.	Hartohet platforma e monitorimit për masat e marra nga shkolla në fillimin e vitit shkollor 2020-2021. Ngrihen grupet e monitorimit në bashkëpunim me MAS.	Raporti i monitorimit në nivel kombëtar.	Tetor 2021	MAS/DVC	U monitoruan 52 ZVAP-të për zbatimin e procedurave të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune dhe

			të lirë pune dhe për miratimin e ngarkesës mësimore të IAP-ve.							u shqyrtuan ngarkesat mësimore të IAP-ve nën juridiksionin e secilës ZVAP, në përputhje me udhëzimet zyrtare.
		2.5.	Vlerësimit i shkollave për cilësinë e shërbimit të ofruar në fushën: "Drejtimi dhe menaxhimi".	**2.5.1.**	Hartimi i platformës së vlerësimit. Hartimi i treguesve të vlerësimit. Ngritja e gupeve të vlerësimit. Hartimi i raportit të vlerësimit për çdo shkollë.	Hartohet platforma për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar nga shkolla në fushën: "Drejtimi dhe menaxhimi", si dhe treguesit e vlerësimit. Vlerësimi i shkollave realizohet sipas shkallës së vlerësimit, të përcaktuar në Kornizën e Vlerësimit të Cilësisë së shkollës, ASCAP 2020.	Raportet e vlerësimit për çdo shkollë.	Nëntor-dhjetor 2021	DVC/ DPAP/DRAP-et/ZVAP-të	U vlerësuan 327 shkolla në ZVAP-të Kolonjë, Devoll, Korçë, Maliq, Pogradec, Përrenjas, Librazhd, Peqin, Sarandë,

					Hartimi i raportit të vlerësimit në rang kombëtar.					Finiq, Gjirokastër, Përmet, Tepelenë, Rrogozhinë, Kavajë, Durrës, Klos, Bulqizë dhe Dibër.
		2.6.	Të monitorohen agjencitë trajnuese për efektivitetin e trajnimeve.	**2.6.2.**	Hartimi i metodologjisë dhe platformës së monitorimit.	Hartimi i urdhrit, metodologjisë, platformës dhe pyetësorëve për vlerësimin e efektivitetit të agjencive trajnuese.	Metodologjia dhe platforma e monitorimit.	3-mujore	DVC	Është hartuar metodologjia dhe platforma e monitorimit. Nuk është realizuar për shkak të pandemisë.
3.	**Ngritja e kapacitetev e**	**3.1.**	Të ngrihet rrjeti profesional i	**3.1.1**	Hartimi i metodologjisë.	Hartohet metodologjia për ngritjen e rrjetit profesional të vlerësuesve të IAP-ve dhe modulet teorike/praktike	Metodologjia, modulet teorike/prakti	Vjetore	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj, Sh. Muça	Është hartuar kalendari i veprimtarive, metodologjia,

			vlerësuesve të IAP-ve.			përkatëse. Hartohet në bashkëpunim me Shkollën e Drejtorëve draft projekti "Rrjeti i vlerësuesve në nivel kombëtar".	ke, draft projekti.			modulet teorike/praktike dhe draft projekti.
		3.2.	Të trajnohen drejtuesit ë shkollave për paketën e vlerësimit të cilësisë.	**3.2.1.**	Hartimi i metodologjisë së trajnimit. Trajnimi i drejtuesve të shkollave në nivel kombëtar. Testimi. Certifikimi.	Hartohet metodologjia e trajnimit. Realizohet testimi. Përgatiten certifikatat e trajnimit.	Metodologjia Testimi Certifikimi	Vjetore	DVC	Janë trajnuar rreth 850 drejtues shkollash në rang kombëtar, në lidhje me paketën e vlerësimit të cilësisë së shkollës.
4.	**Të tjera (jashtë planit)**	**4.1.**	Të vlerësohen videot dhe PPT-të për mësimin online.	**4.1.1.**	Vlerësimi i videove dhe PPT-ve.	Vlerësimi i videove dhe PPT-ve në lëndët matematikë klasa II dhe III, dituri natyre dhe qytetari klasa V, TIK, Matematikë AMU, si dhe redaktimi gjuhësor për AMU-në.	Vlerësimi i videove dhe PPT-ve.	3-mujore	E. Veli, Sh. Muça, Z. Kurti, K. Josifi	Janë vlerësuar videot dhe PPT-të.

		4.2.	Të hartohet testi i kualifikimit të mësuesve të AF.	**4.2.1.**	Testi i kualifikimit.	Hartimi i testit të kualifikimit.	Testi i kualifikimit.	3-mujore	E. Veli	Është hartuar testi i kualifikimit AF.
				4.2.2.	Rivlerësimi testeve të ankimuara.	Rivlerësimi i 56 testeve të ankimuara nga mësuesit e AF.	Testet e rivlerësuara.	mujore	E. Veli	Janë rivlerësuar 56 teste.
		4.3.	Të hartohet Strategjia e Arsimit Parauniversitar.	**4.3.1.**	Hartimi i fushës "Menaxhimi i sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar".	Analiza dhe hartimi i objektivave për fushën "Menaxhimi i sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar", si dhe reflektimi i rekomandimeve të dhëna nga të tretët.	Draft fusha: "Menaxhimi i sigurimit të cilësisë në AP".	6-mujore	T. Çobaj, E. Veli, M. Ucaj	Është hartuar draft fusha: "Menaxhimi i sigurimit të cilësisë në AP".
		4.4.	Të monitorohen provimet e MSH-së.	**4.4.1.**	Monitorimi i provimeve të MSH-së.	Monitorimi i katër provimeve të MSH dhe përgatitja e informacionit të monitorimit.	Informacioni i monitorimit.	Qershor	DVC	Informacionet e monitorimit.

Përgatitën raportin vjetor të ASCAP

Gerti Janaqi – Drejtor i përgjithshëm, ASCAP

Dorina Rapti – Drejtor, Drejtoria e Kurrikulës dhe Kualifikimit, ASCAP

Bashkim Muça – Drejtor, Drejtoria e Performancës, ASCAP

Teuta Çobaj – Drejtor, Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë, ASCAP